

HARTIMI I ARGUMENTIT PËR INVESTIMIN NË KUJDESHIN UNIVERSAL PA PAGESË PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

NJË ANALIZË E KOSTOVE TË KUJDESHIT PËR FËMIJËT, EFEKTEVE MBI TË ARDHURAT FISKALE DHE CENUESHMËRISË SHUMËDIMENSIONALE ME NË QENDËR GJININË



HARTIMI I ARGUMENTIT PËR INVESTIMIN NË KUJDESIN UNIVERSAL PA PAGESË PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

NJË ANALIZË E KOSTOVE TË KUJDESIT PËR FËMIJËT, EFEKTEVE MBI TË ARDHURAT
FISKALE DHE CENUESHMËRISË SHUMËDIMENSIONALE ME NË QENDËR GJININË



UN Women është organizata e Kombeve të Bashkuara e përkushtuar për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Si organizatë kampione për gratë dhe vajzat, UN Women u themelua me qëllim përsheptimin e ecurisë për përmbushjen e nevojave të tyre në mbarë botën.

UN Women zyra e Shqipërisë,
Rr. "Skenderbej", Ndërtesa 8, Ap. 29-31, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 450 2555/7575
E-mail: unwomen.albania@unwomen.org
Website: <https://albania.unwomen.org>

Ky botim është hartuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Mbështetje për financimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm", i financuar nga Fondi i Përbashkët i Kombeve të bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose cilëndo prej organizatave të lidhura me to.

Për të shkarkuar këtë botim, ju lutemi shkoni në faqen: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications>

Autori: Shakespeare Vaidya
Përpunimi grafik: HL Branding

Të gjitha të drejtat e rezervuara
© UN Women 2022

Tabela e përmbajtjes

SHKURTESAT.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
1. HYRJE	9
1.1 Argumenti për Kujdesin Universal për Fëmijën Pa Pagesë.....	10
1.2 Metodologjia	12
2. ANALIZA E SITUATËS PËR KUJDEsin UNIVERSAL PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI	14
2.1 Panoramë e Punës së Papaguar të Kujdesit dhe Barazisë Gjinore në Shqipëri.....	14
2.2 Ekonomia e Kujdesit Shoqëror.....	14
2.3 Investimet dhe Shpenzimet Publike për Shërbime të Kujdesit Shoqëror	16
2.4 Panoramë e Sistemit të Kujdesit për Fëmijët në Shqipëri	18
3. KOSTO EKONOMIKE DHE PËRFITIMET E KUJDEsin PËR FËMIJËT	19
3.1 Përfitimet e Kujdesit për Fëmijët.....	19
3.2 Kostot e Kujdesit për Fëmijën.....	21
4. KUJDESI UNIVERSAL PËR FËMIJËN DHE EFEKTET FISKALE.....	22
5. PËRFUNDIME	27
5.1 Hartimi i Argumentit Fiskal për Kujdesin Universal për Fëmijën në Shqipëri	27
REFERENCAT	30

Shkurtesat

ECEC	Arsimi dhe Kujdesi në Fëmijërinë e Hershme
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
APK	Anketa e Përdorimit të Kohës
UC	Kujdesi Universal për Fëmijë
UN Women	United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women

Përmbledhje Ekzekutive

Rritja e aksesit në kujdes cilësor për fëmijët mund të ketë ndikime që shtrihen në shumë breza, duke përmirësuar punësimin dhe produktivitetin e grave, rezultatet e fëmijëve, mirëqenien e familjes dhe ekonominë në përgjithësi.

Me gjithë provat e konsiderueshme që tregojnë përfitimin që kujdesi për fëmijët sjell në barazinë ekonomike të grave, për rritjen ekonomike dhe për zhvillimin e fëmijëve, shumë qeveri nuk arrijnë ta shohin kujdesin për fëmijët si të mirë publike, dhe si pasojë nuk i caktojnë burimet e përshtatshme. Familjeve u duhet kështu të përballojnë kostot e larta të kujdesit për fëmijët, miliona gra nuk bëhen pjesë e fuqisë punëtore, dhe gjysma e fëmijëve në botë nuk marrin pjesë në arsimin parashkollor.

Pabarazia gjinore është një nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballen politikëbërësit shqiptarë që po rreken të arrijnë një rritje më të shpejtë më të qëndrueshme dhe më përfshirëse. Në Shqipëri shpenzimet për barazinë gjinore janë modeste dhe arrijnë në 0,05 përqind të PBB-së së vendit.

Ky studim ka shqyrtuar argumentet ekonomike që lidhen me efektet fiskale, pra investimet me fonde publike për kujdesin universal falas për fëmijët në Shqipëri. Objektivat janë të: i) ulët niveli i pabarazisë gjinore në punësim, veprimtarinë e tregut të punës dhe në të ardhura; ii) promovohet kapitali njerëzor përmes shkallës më të madhe të regjistrimit të fëmijëve në programet e të nxënies dhe të zhvillimit të fëmijërisë së hershme; dhe iii) sigurohet akses i barabartë për të gjithë fëmijët në kujdes formal për fëmijët për të mëkuar mundësitë e jetës dhe mirëqenies së fëmijëve. Këto argumente theksohen përmes përlllogaritjes së përfitimeve dhe kostove të këtyre investimeve. Studimi tregon se bazuar në supozime relativisht të kujdesshme, përfitimet tejkalojnë konsiderueshëm kostot. Kështu, kujdesi universal për fëmijët i financuar me fonde publike do të ishte një përdorim i kujdesshëm dhe produktiv i fondeve të pakta publike në Shqipëri.

Me qëllim mbështetjen e këtij argumenti, duhet të plotësohen dy kushte. Së pari, përfitimet duhet të tejkalojnë kostot. Studimi merr në konsideratë në mënyrë gjithëpërfshirëse punën e papaguar të grave dhe burrave kundrejt investimeve publike, duke mundësuar identifikimin e përfitimeve. Studimi ka vlerësuar efektet punëkrijuese dhe fiskale të investimit në kujdesin universal për fëmijët në Shqipëri. Ai përlllogarit kostot e përgjithshme vjetore të investimit në kujdesin për fëmijët që do të rrisnin shkallën e regjistrimit (mbulimit) të fëmijëve në kujdes formal për fëmijët, sipas niveleve të ndryshme të synuara. Për një analizë të tillë janë të munduar qasje të ndryshme, përfshirë edhe krahasimin e shkallës aktuale të regjistrimit me atë të synuar, megjithatë ky studim përdor parametra përkatës për kontekstin shqiptar. Studimi arrin në përfundimin se për çdo dollar të shpenzuar në programe të tilla, krijohen rreth dy ose më shumë dollarë në përfitime për fëmijët dhe prindërit e tyre (për shkak të punësimit).

Përfitimet për prindërit janë pak a shumë të njëjta. Kujdesi për fëmijët u krijon kohë prindërve të bëhen pjesë e fuqisë punëtore, dhe kjo krijon dy përfitime relativisht të qarta. Së pari, prindërit e punësuar paguhen me pagë për pjesëmarrjen e tyre në fuqinë punëtore. Së dyti, duke vijuar punësimin e tyre ndërsa fëmijët janë të vegjël, prindërit kanë mundësi të shmangin mungesat e zgjatura nga fuqia punëtore. Këto mungesa dëmtojnë aftësitë profesionale në një sërë mënyrash dhe rezultojnë në uljen e mundësisë fituese në të ardhmen. Bazuar në studime specifike mbi këto çështje, rritjes në punësim që vjen si pasojë e kujdesit gjithëpërfshirës për fëmijët mund t'i caktohet një vlerë.

Përfitimet e kujdesit për fëmijët janë të ndara në përfitime për fëmijët, sektorin e biznesit dhe në përfitime punësimi për prindërit e fëmijëve. Analiza është përqendruar në efektet e punësimit, duke qenë se të dy llojet e përfitimeve janë kritike për këtë analizë. Kështu, studimi ka analizuar një sërë skenarësh për analizën e përfitimeve dhe kostove lidhur me alternativat e politikave për investimet publike, si:

- a) Skenari 1: Nëse rritet regjistrimi i fëmijëve (sipas parametrave të ILO, 2018)
- b) Skenari 2: Nëse regjistrimi i fëmijëve rritet së bashku me përmirësimin e cilësisë
- c) Skenari 3: Regjistrim universal me shërbime të kujdesit për fëmijët me cilësi të lartë

Në fjalë të tjera, nivelet e investimit janë si vijon:

- a) Investim për rritjen e aksesit
- b) Investim për rritjen e cilësisë
- c) Investim për mbështetjen e përfshirjes

Bazuar në sa më lart, financimet publike mund të justifikohen vetëm nëse një pjesë e konsiderueshme e përfitimeve janë publike, përfshirë dhe ato private, duke qenë se qeveria mund të rrisë tatimet si të ardhura. Megjithatë, studimi argumenton se ka interes të konsiderueshëm publik lidhur me kujdesin universal për fëmijët. Stimulimi i kujdesit për fëmijët mund të ketë efekte të fuqishme dhe afatgjata mbi punësimin prindërve dhe zhvillimin e fëmijëve si në familjet në të cilat prindërit janë të punësuar, ashtu edhe në ato në të cilat nuk janë të punësuar. Gjithashtu, për disa familje, kujdesi i mirë për fëmijët mund t'i lejojë prindërve të ruajnë aftësitë e punës dhe vijojnë përvojën në punë, duke pasur kështu efekte të qëndrueshme mbi të ardhurat familjare.

Në përmbledhje, kur të gjithë këta elementë bëhen bashkë, përfitimet graduale nga ndryshimet e identifikuar për organizimin e kujdesit universal për fëmijët në Shqipëri, arrijnë në rreth dy dollarë për çdo dollar të shpenzuar si kosto (në terma monetarë) nga Qeveria. Kështu, kujdesi universal për fëmijët ka rëndësi për fëmijët, për prindërit dhe për shoqërinë. Përfitimet e një programi të tillë kanë gjasa të jenë konsiderueshëm më të mëdha se kostot, kështu që kujdesi për fëmijët i financuar me fonde publike meriton vëmendje të madhe gjatë vendimmarrjes për caktimin e fondeve të kufizuara publike.

1. Hyrje

Rritja e aksesit në kujdes cilësor për fëmijët mund të ketë ndikime që shtrihen në shumë breza, duke përmirësuar punësimin dhe produktivitetin e grave, rezultatet e fëmijëve, mirëqenien e familjes dhe ekonominë në përgjithësi. Me gjithë provat e konsiderueshme që tregojnë përfitimin që kujdesi për fëmijët sjell në barazinë ekonomike të grave, për rritjen ekonomike dhe për zhvillimin e fëmijëve, shumë qeveri nuk arrijnë ta shohin kujdesin për fëmijët si të mirë publike, dhe si pasojë nuk i caktojnë burimet e përshtatshme. Prindërve u duhet kështu të organizojnë me vështirësi kujdesin për fëmijët, miliona gra nuk bëhen pjesë e fuqisë punëtore, dhe gjysma e fëmijëve në botë nuk marrin pjesë në arsimin parashkollor¹. Kujdesi universal, i përballeshëm dhe me cilësi të lartë për fëmijët është i nevojshëm për të mbështetur prindërit, dhe sidomos gratë, dhe kur ai nuk është i disponueshëm situata bëhet sfiduese, si:

- Mungesa e kujdesit të përballeshëm për fëmijët citohet shpesh si një nga pengesat më të mëdha ndaj mundësive të grave për të punuar, duke kufizuar llojin dhe kohëzgjatjen e punës në të cilën ato mund të angazhohen jashtë banesës².
- Mungesa e kujdesit për fëmijët mund të kufizojë produktivitetin dhe llojin e punësimit në të cilin mund të angazhohen gratë, duke mos i lejuar ato të shfrytëzojnë mundësi më të qëndrueshme dhe më fitimprurëse³.
- Një sërë studimesh dhe anketimesh kanë arritur në përfundimin se kujdesi për fëmijët mundëson angazhimin në punë për një kohëzgjatje më të madhe, produktivitet më të madh dhe të ardhura më të larta dhe punësim në sektorin formal në vend të atij informal.
- Ka një marrëdhënie të fortë ndërmjet pjesëmarrjes së nënave në fuqinë punëtore dhe regjistrimit të fëmijëve në shërbimet e kujdesit për fëmijët⁴.
- Provat nga një sërë disiplinash konfirmojnë se vitet më të hershme të një fëmije janë periudhë kritike gjatë së cilës duhet punuar për krijimin e aftësive themelore.
- Përfitimet e kujdesit cilësor për fëmijët dhe mjedisit të të nxëniet të hershëm përfshijnë gatishmëri më të mirë nga ana e shkollave, normë të ulur të përsëritjes së viteve dhe braktisjes së shkollës, dhe arritje më të mira shkollore⁵.
- Provat nga një sërë kontekstesh sugjerojnë se zhvillimi i aftësive konjitive dhe social-emocionale gjatë viteve më të hershme të një fëmije është kritik për suksesin në vendin e punës dhe në jetën në moshë madhore, duke rezultuar në mundësi më të mira punësimi dhe potencial për të ardhura më të larta⁶.
- Përmirësimi i kujdesit për fëmijët dhe mundësive të punës për gratë mund të përmirësojë produktivitetin e bizneseve, të pakësojë kostot e qarkullimit të punonjësve dhe të sjellë përfitime që lidhen me diversitetin⁷.
- Shtrirja e shërbimeve të kujdesit për fëmijët dhe mbështetja e rritjes së tregut të kujdesit për fëmijët krijojnë potencial për hapjen e vendeve të reja të punës, jep kontribut për punësimin dhe produktivitetin e grave, si dhe për rritjen e ekonomisë në përgjithësi.

Shqipëria ka bërë përmirësime gjatë viteve të fundit, megjithatë papunësia dhe varfëria përbëjnë ende kërcënim për familjet shqiptare dhe vijnë në të kenë ndikim negativ në statusin social të grave në vend. Të dhënat për varfërinë në Shqipëri tregojnë se ky fenomen përfshin shumë femra, si dhe një rritje të numrit të fëmijëve në varfëri. Në Shqipëri, pabarazia gjinore përbën një pengesë të madhe ndaj përshtetimit të uljes së varfërisë. Trajtimi i pabarazisë gjinore luan një rol parësor në përforcimin e mirëqenies për mijëra fëmijë shqiptarë që jetojnë në varfëri.

1. Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët. (2019). Një Botë e Gatshme për të Mësuar: Dhënia Përparësi Arsimit në Fëmijërinë e Hershme Nju Jork: UNICEF. <https://data.unicef.org/resources/a-world-ready-to-learn-report/>.

2. IFC 2017; Hein dhe Cassirer 2010; Diaz dhe Rodriguez-Chamussy 2013; Woetzel et al. 2015; UN Women 2015; World Bank 2018; Revenga dhe Dooley 2020.

3. Alfors 2016.

4. OECD.

5. Heckman dhe Masterov 2007; Engle et al. 2011.

6. Shihni për shembull Cunha dhe Heckman 2007; Cunha et al. 2006; Engle et al. 2011; Garcia, Devercelli dhe Valerio, në botim e sipër; Heckman 2006; Naudeau et al. 2011; Neuman dhe Devercelli 2013; dhe Shafiq, Devercelli, dhe Valerio 2018.

7. IFC 2017.

Pjesa e punës së papaguar në ditë zë 21,74 përqind të kohës për gratë dhe vetëm 3,47 përqind për burrat, që do të thotë se gratë nuk paguhen për çerekun e punës së kryer, qoftë kjo në familje apo në vendin e punës. Gratë shqiptare kalojnë 21,74 përqind të ditës së tyre duke kryer punë të papaguar, përfshirë gatimin, pastrimin dhe kujdesin për fëmijët dhe pjesëtarët e familjes. Kjo situatë ka ndikime të konsiderueshme financiare dhe ekonomike për gratë dhe për shoqërinë në përgjithësi. Familjet kanë vështirësi në përfitim të kujdesit për fëmijët dhe gratë janë të detyruara të bëjnë zgjedhje të vështira ndërmjet kujdesit të papaguar dhe karrierës së tyre. Kujdesi për fëmijët është një nga sektorët e punësimit me më shumë femra në Shqipëri dhe edukatoret e fëmijërisë së hershme janë ndër punonjësit më të nënvlerësuar, duke sjellë si pasojë shkallën e ulët të qëndrimit në vendin e punës, nivelin e ulët të kënaqësisë në punë dhe mungesën e krahut të punës.

Zbatimi i një sistemi publik të kujdesit për fëmijën të përbalueshëm, të aksesueshëm, me cilësi të lartë dhe përfshirës për të gjitha familjet në Shqipëri është i mundur nëse ngrihet një sistem universal i kujdesit për fëmijën. Kjo do të ishte me përfitim për barazinë gjinore, për ekonominë dhe për vetë fëmijët. Kujdesi universal për fëmijët është një nga investimet më inteligjente që qeveria mund të bëjë për ta bërë Shqipërinë më përfshirëse, më të barabartë dhe për të rritur prosperitetin. Mbështetësit e kujdesit për fëmijën kanë kërkuar gjatë investime të shtuara (leadership) nga ana e qeverisë dhe ata kanë paraqitur një udhërrëfyes të qartë, përkatësisht Kujdesin Universal për Fëmijën. Ka ardhur koha që Qeveria e Shqipërisë të pranojë këtë sfidë.

1.1 Argumenti për Kujdesin Universal për Fëmijën Pa Pagesë

Me raste kujdesi universal për fëmijët është i përkufizuar si "falas". Një raport i UNICEF-it i vitit 2008 vlerësoi programet e ECEC-it në 25 vende. Ai përmbledh, siç paraqitet më poshtë, disa nga argumentet kyçe për krijimin e shërbimeve të fëmijërisë së hershme si programe universale dhe jo si programe që synojnë grupe të veçanta fëmijësh (Qendra Kërkimore Innocenti e UNICEF, 2008: 17, 18).

- Shërbimi është i disponueshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëtarët e grupit. E drejta për akses të barabartë mund të përkufizohet në legjislacion.
- Shërbimet janë të financuar plotësisht ose në mënyrë thelbësore me fonde publike.
- Shërbimet planifikohen zakonisht në sektorin publik me procese të përcaktuara për vlerësimin e kërkesës dhe ngritjen ose dhënien e lejeve për shërbime të përshtatshme që plotësojnë nevojat e identifikuar.

Raportet e BE-së dhe Bankës Botërore tregojnë se mungesa e shërbimeve të aksesueshme dhe përbalueshme të kujdesit për fëmijën në Shqipëri është një nga pengesat më të mëdha lidhur me pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, duke përfshirë këtu nivelin e ulët të investimeve në të nxënit e hershëm dhe kujdesin për fëmijët. Shqipëria është e ndarë në shumë mënyra. Shqiptarët dallohen bazuar në cilësi si pasuria, arsimi, vendbanimet urbane dhe rurale, seksi, mosha, grupet me bazë familjen, lidhjet politike, etnia dhe të tjera. Aksesit i individëve dhe grupeve në burime ekonomike, sociale dhe politike është tejet i pabarabartë. Nevojitet vëmendje dhe mbështetje për lehtësimin e përfshirjes së popullatave të veçanta: grupet e marginalizuara dhe të cenueshme, të varfrit dhe Romët dhe Egjiptianët, si dhe personat me aftësi të kufizuara, si pjesë të rëndësishme të këtyre grupeve.

Për më tepër, pabarazia gjinore është një nga sfidat më të mëdha me të cilën përballen politikëbërësit shqiptarë tek mundohen të arrijnë një rritje më të shpejtë, më të qëndrueshme dhe më përfshirëse. Buxhetimi gjinor është mbështetur vazhdimisht gjatë viteve të shkuara. Gjithashtu, shoqëria civile ka bërë përpjekje të dukshme për sigurimin e analizave të ekspertëve gjinorë dhe për shtrirjen e debatit mbi politikat fiskale, duke treguar se buxhetimi gjinor jep kontribut për rezultatet e mira për gratë dhe fëmijët, veçanërisht sa i përket përfitimeve shoqërore dhe ekonomike që lidhen me barazinë dhe fuqizimin ekonomik të grave. Megjithatë, shpenzimet për barazinë gjinore në Shqipëri janë modeste dhe përbëjnë 0,05 përqind të PBB-së së vendit.

- Në Shqipëri, gratë kanë nevojë për kujdes të përbalueshëm për fëmijën, në mënyrë që të kenë mundësi të ndjekin mundësi dinjitoze për punësim. Ky është element kyç për forcimin e sigurisë ekonomike dhe sigurisë së grave. Kjo është theksuar edhe nga gjetjet e anketimit të organizuar kohët e fundit për ndikimin e COVID-19. Shumica e grave të intervistuar u përgjigjën se ato e kishin të vështirë të gjenin shërbime të kujdesit për fëmijët e tyre. Pyetjes se si kjo ndikonte në familjen e tyre, ato iu përgjigjën se kishin

ndryshuar oraret e punës, kishin punuar më pak nga sa dëshironin, dhe se kishin shtyrë kthimin e tyre në vendin e punës.

- Shpërndarja e përgjegjësive të kujdesit në Shqipëri është jashtëzakonisht e pabarabartë, ku pjesa më e madhe e kujdesit jepet në familje dhe kryesisht nga gratë si punë e papaguar.
- Puna e papaguar përbën rreth 60% të PBB-së në Shqipëri⁸. Vlera e kësaj pune është 84 USD (71 Euro) bazuar në pagën mesatare mujore prej 390 USD (330 Euro), dhe kur merret në konsideratë se 35% e rreth 1,08 milion grave në Shqipëri janë të punësuar, ekonomia shqiptare po humb një potencial prej 32 milion USD (27 milion Euro) çdo muaj⁹. Kjo përkthehet në një shumë prej 385 milion USD (324 milion Euro) në vit.
- Pjesa e punës së papaguar në ditë zë 21,74 përqind të kohës për gratë dhe vetëm 3,47 përqind për burrat, që do të thotë se gratë nuk paguhen për rreth çerekun e punës së kryer, qoftë kjo në familje apo në vendin e punës. Gratë shqiptare kalojnë 21,74 përqind të ditës së tyre duke kryer punë të papaguar, përfshirë gatimin, pastrimin dhe kujdesin për fëmijët dhe pjesëtarët e familjes.
- Përpara periudhës së COVID-19, gratë i kushtuan punës së papaguar më tepër orë (21,74% të ditës) krahasuar me burrat.
- Punësimi informal përbën rreth 61% të punësimit të përgjithshëm në Shqipëri.
- Me gjithë rëndësinë që ka, ky lloj punësimi vijon të mos jetë i dukshëm dhe nënvlerësohet e shmanget gjatë hartimit të politikave makroekonomike dhe shoqërore.
- Shpenzimet për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri janë thuajse të papërfillshme dhe përbëjnë rreth 3% të programit të përgjithshëm buxhetor për mbrojtjen sociale (përfshirë fëmijët).
- Përveç mbizotërimit të femrave në punën e papaguar të kujdesit, gratë janë të mbipërfaqësuar edhe në fushën e punës së paguar të kujdesit, që në përgjithësi karakterizohet nga paga të ulëta dhe kushte të paqëndrueshme.
- Një sërë studimesh kanë theksuar nivelin e informalitetit në Shqipëri. Një studim i vitit 2010 ka vlerësuar se ekonomia informale e vendit ishte e barabartë me 32,9 përqind të PBB së tij.¹⁰ Punime të tjera kërkimore kanë treguar se 40 përqind e punëtorëve pranojnë se ata janë të detyruar të konkurrojnë me sektorin informal.¹¹ Çka është më alarmante është se Qeveria e Shqipërisë ka konfirmuar në vitin 2015 se ekonomia informale arrin në deri 50 përqind të PBB-së. Punësimi informal është i formave dhe llojeve të ndryshme. Për shembull, 39,75 përqind e punonjësve kanë deklaruar se nuk kishin një kontratë pune me shkrim me punëdhënësin, ndërsa 30,29 përqind deklarojnë se nuk paguanin kontributet e tyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.¹²

Kujdesi Universal për Fëmijën

Do të ishte mirë që sistemi i kujdesit për fëmijët të ishte universal. Kjo nuk do të thotë që sistemi duhet të jetë i detyrueshëm dhe njësoj për të gjithë dhe nuk do të thotë se kujdesi për fëmijët duhet të jetë me doemos falas. Kjo nuk do të thotë që duhet të ofrohet vetëm një lloj i shërbimit të kujdesit për fëmijët (pra programe qeveritare apo institucionale). Faktikisht universaliteti nënkupton mundësimin e aksesit për të gjithë fëmijët prindërit e të cilëve dëshirojnë të marrin pjesë, pa diskriminim bazuar në të ardhura apo kritere të tjera. Një qasje universale kërkon një sistem të financuar dhe menaxhuar nga sektori publik, i cili ofron një gamë të gjerë shërbimesh të ofruara nga ofrues publikë dhe jo fitimprurës sipas nevojave të familjeve.

Studimet ndërkombëtare, vlerësimet e programeve dhe matjet e cilësisë kanë treguar në mënyrë të përsëritur se pjesëmarrja në të nxënit e hershëm dhe programet e kujdesit ka ndikim pozitiv në zhvillimin konjitiv dhe gjuhësor si dhe në lumturinë e fëmijëve, dhe ka ndikime afatgjata mbi arsimin, punësimin dhe të ardhurat e tyre. Por cilësia e kujdesit është kritike, sepse efektet e kujdesit të dobët mbi zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve mund të jenë afatgjata.

Në fjalë të tjera, një trup i madh pune kërkimore ka treguar se mungesa e ofrimit të kujdesit të përbalueshëm dhe të aksesueshëm për fëmijët lidhet me efekte afatgjata negative mbi pabarazitë gjinore gjatë jetës. Për më

8. Dokument Pune i FMN-së, 2019.

9. Ibid.

10. Universiteti Johannes Kepler, 2010.

11. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), 2013.

12. Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) & Liderhipi i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI), 2016.

tepër, aksesit në kujdes për fëmijët me cilësi të lartë për një kohëzgjatje të konsiderueshme gjatë javës është kritik për përmirësimin e rezultateve të fëmijës dhe mundësive gjatë jetës, edhe për fëmijët e vegjël dhe foshjat, veçanërisht ata nga grupet e disavantazuara.

Megjithatë, me gjithë ndërhyrjen e qeverisë në sektor, ofrimi i kujdesit për fëmijët në Shqipëri është ende kryesisht i paaksesueshëm dhe i papërbalueshëm për shumë prindër, veçanërisht ata që janë më së shumti të përfshirë në punë të papaguar. Aktualisht mbështetja e nevojshme qeveritare për ta bërë sistemin e kujdesit për fëmijët të suksesshëm është shumë e pakët ose e papërshtatshme në Shqipëri. Sistemi është i përbërë nga një përzierje komplekse me mbështetje të drejtpërdrejtë për ofruesit, ndërsa mbështetja për familjet dhe mbështetja në mjete monetare për familjet me të ardhura të ulëta nuk janë të përshtatshme.

Pavarësisht këtyre formave të mbështetjes të synuara për familjet e disavantazuara, sistemi shqiptar karakterizohet nga nivele të larta pabarazie në përdorim, pjesërisht si pasojë e kostove të larta dhe mungesës së aksesit sipas kërkesave. Një zgjidhje e sugjeruar është të investohet në shkallë të gjerë në kujdesin formal, me kohë të plotë, dhe falas për të gjithë fëmijët, me staf të mirëtrajnuar dhe mirëpaguar, të ngjashëm me arsimin shkollor universal falas. Ky vlerësim merr në konsideratë kostimin dhe mundësitë e financimit të një investimi të tillë për fëmijët nga mosha 6 mujore deri në atë 4 vjeçare.

1.2 Metodologjia

Studimi synon të vlerësojë argumentin fiskal për rritjen e shpenzimeve publike për shërbime të kujdesit shoqëror, veçanërisht për kujdesin universal për fëmijët përmes të dhënave parësore dhe dytësore, duke vlerësuar gjithashtu mundësinë e reduktimit të punës së papaguar të kujdesit dhe nxitjen e punësimit në nivele të ndryshme të sektorit. Gjithashtu vlerësimi bëhet në kuadrin e krijimit të vendeve të reja të punës si pasojë e investimit të shtuar në kujdesin për fëmijë si dhe sigurimit të mundësive për punonjësit e papunë dhe familjet e tyre, duke marrë në konsideratë edhe ndikimet e mundshme mbi barazinë gjinore dhe varfërinë në nivelin mikroekonomik.

Matja dhe Vlerësimi i Punës së Papaguar

Vlera e plotë ekonomike e një veprimtarie është e barabartë me kohën e përdorur për veprimtarinë shumëzimit "çmimin" ose njësinë e vlerës së veprimtarisë në fjalë për njësi kohe. Identifikimi i vlerës së përshtatshme të njësisë së punës së papaguar është i vështirë, dhe për këtë arsye literatura mbi përdorimin e kohës ofron disa metoda për këtë përlogaritje. Më konkretisht, vlera e punës së papaguar mund të përcaktohet përmes një qasje të bazuar në kontribut ose bazuar në produkt.

Qasja e bazuar në produkt ngre pyetjes se sa do të kushtonte blerja e një shërbimi të kujdesit të papaguar në treg (për shembull, një orë kujdesi e ofruar në një institucion). Çmimi i tregut për shërbimin që zëvendëson veprimtarinë i caktohet më pas të mirave apo shërbimeve jashtë tregut. Megjithatë, kjo metodë paraqet një sërë vështirësish konceptuale lidhur me përkufizimin e produktit të punës së papaguar të kujdesit, si kujdesi për fëmijët. Gjithashtu, qasja e bazuar në produkt kufizohet nga vështirësia e mbledhjes së të dhënave të saktë të çmimeve të tregut për produktet me cilësi dhe volum të barasvlershëm me të mirat dhe shërbimet e gjeneruara nga puna e papaguar e kujdesit.

Qasja e bazuar në kontribut përqendrohet në matjen dhe vlerësimin e kontributit të punës që jepet në kuadër të punës së papaguar të kujdesit. Në parim, edhe kontributet e tjera si ato të kapitalit apo kostot e tjera duhet të maten, por puna është kontributi më i rëndësishëm.

Me qëllim vlerësimin e efekteve fiskale, kjo analizë përdor tabelat zyrtare të kontributit dhe produktit të hartuara nga INSTAT, për përlogaritjen e efekteve të plota të punësimit të punësimit shtesë, të krijuar për shembull në sajë të shpenzimeve qeveritare, lidhur me produktet e një industrie të veçantë, si shërbimet e kujdesit. Ky studim përqendrohet në efektet e punësimit duke përlogaritur ndryshimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe të krijuara të punësimit si pasojë e një rritjeje të njësisë në kërkesën fundore. Studimi përlogarit gjithashtu efektet e drejtpërdrejta, tërthorta dhe të krijuara të punësimit, përfshirë efektin total të punësimit,

apo përbërësve të tij, për të përlogaritur sasinë e punësimit shtesë të krijuar. Matrica e simulimit për kontributin dhe produktin është dhënë në Shtojcën 1.

Një kërkim në burimet statistikore përkatëse për nevojat e kujdesit për fëmijët në Shqipëri, tregon se të dhëna të ndryshme statistikore masin dhe raportojnë lidhur me aspekte të ndryshme të shërbimeve të kujdesit. Anketimet e Përdorimit të Kohës (APK), të zhvilluara nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), janë burimi më i rëndësishëm i të dhënave për punën e papaguar të kujdesit në shtëpi. Anketimet e tjera ofrojnë të dhëna plotësuese. Gjithashtu me dobi është edhe anketimi "Të Ardhura dhe Kushtet e Jetesës në Shqipëri, 2019" i përpiluar nga INSTAT. Disa nga burimet e të dhënave janë anketime të veçanta të zhvilluara për qëllime të veçanta. Për këtë arsye, ky studim përdor të gjitha burimet e të dhënave dhe informacionit.

Të dhënat e përdorimit të kohës bëjnë të mundur matjen e kohëzgjatjes që i kushtohet punës së papaguar të kujdesit, por këto të dhëna mund të kenë disa kufizime, si:

- Anketimet e përdorimit të kohës (APK) kanë si synim parësor matjen e funksioneve të veçanta, si përgatitja e vakteve, pastrimi i shtëpisë, apo ushqimi i fëmijë, dhe si të tilla bazohen në veprimtari parësore dhe dytësore.
- Pak APK përfshijnë të gjithë pjesëtarët në moshë madhore në një familje. Ndërkohë që të dhënat e kohës mund të përdoren për matje të përafërta për totalin e punës së papaguar të kujdesit, matja e vlerës së punës së papaguar të kujdesit në lloje të ndryshme familjesh është e vështirë, kur mbledhen të dhëna vetëm për një person në moshë madhore që jep kujdes të papaguar.
- Shpesh APK-të zhvillohen të ndara nga anketime të tjera në familje, si ato për shpenzimet konsumatore apo pasurinë e familjes. Janë bërë disa përpjekje për mbledhjen e të dhënave për përdorimin e kohës si modul i anketimeve të tjera, si Anketimi e Matjes së Standardit të Jetesës, anketimet e të ardhurave dhe shpenzimeve, apo LFS-ve.


Në kuadër të këtyre problematikave metodologjike dhe teknike, studimi përfshin gjerësisht kujdesin për fëmijët dhe pjesëtarët e tjerë të varur të familjes (si të moshuarit, të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara) dhe veprimtaritë e nevojshme për mirëmbajtjen dhe administrimin e familjes (si gatimin dhe pastrimin) në kuadrin e veprimtarive të papaguara. Termi "i/e papaguar" përcakton se personi që po kryen veprimtarinë nuk shpërblehet për të, duke e lënë veprimtarinë jashtë kufijve të prodhimit të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA).

2. Analiza e situatës për kujdesin universal për fëmijët në Shqipëri

2.1 Panoramë e Punës së Papaguar të Kujdesit dhe Barazisë Gjinore në Shqipëri

Përgjegjësia e punës së papaguar bie në raport të zhdrejtë mbi gratë dhe vajzat, duke u lënë atyre më pak kohë për arsim, argëtim, pjesëmarrje politike, punë të paguar dhe veprimtari të tjera ekonomike. Në këtë kontekst, puna e papaguar është themelore për jetën ekonomike dhe për mirëqenien individuale dhe shoqërore. Sektori i punës së papaguar të kujdesit është identifikuar prej kohësh si një pengesë kritike ndaj barazisë gjinore dhe fuqizimit ekonomik e shoqëror të grave. Në shumicën e vendeve, kjo lloj pune klasifikohet si punë jashtë tregut, dhe si pasojë nuk konsiderohet në kuadër të sistemeve të llogarive kombëtare dhe PBB-së. Kështu, ajo bëhet e padukshme në politikat ekonomike dhe sociale, duke qenë se politikëbërësit zakonisht e shohin kujdesin për fëmijët si pjesë të ciklit të jetës të gruas dhe si çështje familjare. Si pasojë, kjo çështje vijon të ekzistojë si normë gjinore shoqërore dhe kulturore. Pandemia e COVID-19 ka hedhur më shumë dritë mbi rëndësinë e punës së papaguar lidhur me jetën sociale dhe ekonomike, duke qenë se barra e kujdesit u rrit në sajë të masave qeveritare të mbylljes.

Shqipëria nuk përbën përjashtim në këtë pikëpamje. Për gratë në Shqipëri është e zakonshme që një pjesë e madhe e kësaj pune t'i kushtohet kujdesit për pjesëtarët e familjes dhe punëve të shtëpisë. Puna e kujdesit zgjat për një kohë të konsiderueshme në Shqipëri, veçanërisht në rastet kur infrastruktura është e dobët dhe shërbimet publike janë të kufizuara ose mungojnë. Barra e punës së kujdesit është veçanërisht e lartë në shoqëritë në plakje. Kjo barrë mund të kufizojë angazhimin e grave në veprimtari që krijojnë të ardhura dhe i drejtojnë ato të përqendrohen në punë të paguar pak, informale dhe të bazuar në shtëpi, si mënyrë për ekuilibrimin e punës së papaguar të kujdesit me punësimin e paguar.



2.2 Ekonomia e Kujdesit Shoqëror

Ekonomia e kujdesit shoqëror koncept është relativisht i ri, por me rëndësi të madhe dhe gjithmonë e në rritje në ekonominë shqiptare dhe mirëqenien ekonomike të qytetarëve, veçanërisht grave. Puna e kujdesit, si e paguar dhe e papaguar, ndikon në mirëqenien ekonomike të grave. Shërbimet e kujdesit me pagesë karakterizohen nga një fuqi punëtore e përbërë kryesisht nga femra dhe me nivele të larta punësimi rastësor dhe me kohë të pjesshme. Kujdesi informal ndikon negativisht në të ardhurat e grave gjatë jetës së tyre. Kërkesa për kujdes rritet gjatë periudhave të rënies ekonomike si pandemia e COVID-19 dhe roli thelbësor i mbështetjes publike në sektorin e kujdesit e bën sektorin veçanërisht të cenueshëm në këtë situatë.

Historikisht, puna e papaguar ka qenë përgjegjësi i familjes (ILO, 2018). Puna e papaguar mund të përkufizohet si “të gjitha veprimtaritë jo formale dhe të pa shpërblyera, si kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit dhe kujdesi i tërthortë, si gatimi dhe pastrimi”. Në përgjithësi, anketimet e përdorimit të kohës përdoren për mbledhjen e të dhënave për punën e papaguar. Anketimi i përdorimit të kohës për vitin 2010-11 në Shqipëri do të përdoret për qëllime analize¹³.

Tabela 1: Vlera e Punës së Papaguar si Përqindje e PBB-së për Gratë dhe Burrat, USD/për frymë, 2011

Vendi	Gra	Burra
Shqipëri	7.2	1.2

Tabela 2: Kohëzgjatja Ditore e Kaluar në Punë të Papaguar dhe në Punë të Paguar (Orë brena një Periudhe 24 orëshe)

Vendi	Viti i Anketës së Përdorimit të Kohës	Mosha	Puna e Paguar e Burrave	Puna e Papaguar e Burrave	Puna e Paguar e Grave	Puna e Papaguar e Grave
Shqipëria	2010-11	10+	4.27	0.83	1.93	5.22

- Sa i përket punës së papaguar riprodhuese, burrat shqiptarë kontribuojnë vetëm 14,2% të të gjithë punës së papaguar të kujdesit, ndërsa gratë kalojnë më shumë se pesë orë çdo ditë me punë të papaguar shtëpie¹⁴.
- Më shumë se një e treta e grave në Shqipëri (37 përqind) japin kontribut në bizneset familjare (OKB, 2020a).
- Barra më e madhe është raportuar nga gratë në Shqipëri (72 përqind kundrejt 61 përqind)
- Norma e pjesëmarrje së grave dhe burrave në fuqinë punëtore (2019) ishte 72,1 përqind kundrejt 88,3 përkatësisht me një dallim të konsiderueshëm prej 16,2 përqind ndërmjet burrave dhe grave¹⁵.
- Në Shqipëri, 75 deri 80 përqind e grave kanë raportuar më shumë vështirësi krahasuar me periudhën përpara pandemisë lidhur me përmbushjen e nevojave bazë dhe mbulimin e shpenzimeve bazë, si pagesën e qirasë, shërbimeve komunale dhe ushqimit, si pasojë e humbjes së burimeve jetësore si remitancat apo të ardhurave bujqësore¹⁶.
- 69 përqind e grave në Shqipëri janë përballur me shkallë më të lartë vështirësish psikologjike krahasuar me burrat

Tabela 3: Leja e Lindjes për Baballarët dhe Leja Prindërore në Shqipëri

	Kohëzgjatja e Lejes së Lindjes për Baballarët	Sasia e Lejes së Lindjes për Baballarët Përfitimet në Mjete Monetare	Sasia e Lejes Prindërore: Përfitimet në Mjete Monetare
Shqipëri	17 javë	100%	Vetëm nënat: 52 javë 26 javët e para (përfshirë paralindjen): 80% e pagës neto

13. https://w3.unece.org/PXWeb2015/pxweb/en/STAT/STAT__10-CountryOverviews

14. ILO 2019

15. UN Women, 2020a

16. UN Women (2020). The Impact of Covid-19 on Women's and Men's Lives and Livelihoods in Albania: Results of a Rapid Gender Assessment. Preliminary Results from a Rapid Gender Assessment, <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods>

17. Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

18. Sistemi Evropian i Statistikave të Integruara të Mbrojtjes Sociale (ESSPROS)

2.3 Investimet dhe Shpenzimet Publike për Shërbime të Kujdesit Shoqëror

Sistemi shqiptar i kujdesit shoqëror ofron shërbime publike dhe jopublike për persona në nevojë për shërbime rezidenciale dhe ditore. Shërbimet shoqërore publike ofrohen kryesisht përmes qendrave të shërbimit rezidencial dhe ditore dhe financohen nga buxheti i shtetit dhe i bashkive. Që prej vitit 2002, qeveritë kanë punuar për reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por ende nuk është përcaktuar një formulë e zbatueshme për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Qasja aktuale ka përfshirë transferimin e pronësisë së institucioneve të kujdesit shoqëror dhe përgjegjësisë të ofrimit të shërbimit autoriteteve të qeverisjes vendore, si dhe një kombinim të planifikimit dhe monitorimit autoriteteve në nivel qarku dhe institucioneve në nivel qendror.

Ligji për vetëqeverisjen vendore¹⁷ përcakton funksionet dhe autoritetin e qeverisjes vendore. Në fushën e shërbimeve shoqërore, bashkitë kanë përgjegjësinë të ngrenë dhe menaxhojnë shërbimet vendore të kujdesit shoqëror; ndërtojnë dhe administrojnë qendrat e kujdesit shoqëror dhe banesat sociale. Ligji për vetëqeverisjen vendore i vitit 2015 përcakton gjithashtu përgjegjësinë e bashkive për të krijuar një "fond social për financimin e shërbimeve shoqërore", në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

Shpenzimet për mbrojtjen sociale në Shqipëri përbëjnë 9,3% të PBB-së, një vlerë kjo konsiderueshëm më e ulët se mesatarja e BE-së prej 28%¹⁸³³. Shpenzimet janë të mbizotëruara nga shpenzimet për sigurimet shoqërore (program kontributësh), që përbëjnë më shumë se 80% të shpenzimeve të përgjithshme ndërmjet vitit 2015 dhe 2019. Dy programet e tjera kryesore të mbrojtjes sociale janë ndihma ekonomike dhe përfitimet e aftësisë së kufizuar, të cilat mesatarisht përbëjnë 13% të shpenzimeve të përgjithshme publike sociale gjatë të njëjtës periudhë. Pjesa e mbetur e shpenzimeve në fushën e politikave sociale i kushtohet programeve aktive dhe pasive të punësimit, aktualisht të administruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (rreth 1% e buxhetit të përgjithshëm) si dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor, emergjencave dhe menaxhimit të strategjisë së mbrojtjes sociale.

Tabela 4: Shpenzimet për Mbrojtjes Sociale në Shqipëri 2015-2021

Programi Buxhetor milion LEK	Viti						
	2015	2016	2017	2018	2019	2020*	2021*
Shërbimet e kujdesit shoqëror (shpenzimet e pakushtëzuara)	493	528	684	842	1 135	1 135	1 135
Programi Buxhetor i Mbrojtjes Sociale	21 442	21 283	21 614	21 445	23 542	23 987	24 926
Nga të cilat: programet e ndihmës ekonomike në para	17 662	20 026	20 714	20 671	21 100	21 000	21 300
Nga të cilat: bonusi i bebes					1 870	2 000	2 500
Nga të cilat: Shërbimet të kujdesit shoqëror dhe kosto të tjera menaxhimi në MS ³⁴	3 780	1 257	900	988	988	987	1 126
Përfshirja Sociale	93	68	88	13			
Shërbimet e Punësimit	1 623	1 807	1 486	1 228	1 535	1 951	2 151
Nga të cilat: përfitime papunësie (pasive)	615	691	346	336	540	600	600
Emergjencat	1 419	1 266	1 109	1 542	1 503	434,25	1 020
Nëntotali i shpenzimeve në sektorin social (jo kontribute)	24 977	24 884	24 893	25 057	27 715	27 507	29 232
Fondi i Sigurimeve Shoqërore (pensionet)	107 309	114 276	119 081	125 364	130 927	137 468	142 965
Shpenzimet gjithsej për mbrojtjen sociale	132 286	139 160	143 974	150 421	158 642	164 975	172 197
PBB	1 434 307	1 475 251	1 552 886	1 647 625	1 705 246	1 793 466	1 905 129
Buxheti Total i Përgjithshëm i Qeverisë	433 697	440 241	461 410	476 147	519 577	549 374	554 858
Mbrojtja sociale (pa sigurimet shoqërore)							
si % e PBB-së	1,7%	1,70%	1,60%	1,50%	1,50%	1,40%	1,50%
Si % e buxhetit të përgjithshëm qeveritar	5,8%	5,70%	5,40%	5,30%	5,10%	4,90%	5,10%
Programet e mbrojtjes sociale në para							
Si % e buxhetit të përgjithshëm qeveritar	4,1%	7,7%	7,7%	7,6%	7,5%	7,4%	7,3%
In % of social spend Si % e shpenzimeve sociale (jo kontribute) ing (non contr.)	70,7%	80,5%	83,2%	82,5%	82,9%	83,6%	81,4%
Si % e programit buxhetor të kujdesit shoqëror (qendror)	82,4%	94,1%	95,8%	96,4%	97,6%	95,9%	95,5%
Shpenzimet shoqërore (të pakushtëzuara) të qeverisjes vendore							
Si % e shpenzimeve sociale (jo kontribute)	3,4	2,0%	2,1%	2,7%	4,1%	4,1%	3,9%
Si % e programit buxhetor të kujdesit shoqëror (qendror)	3,9	2,3%	2,5%	3,2%	4,8%	4,7%	4,6%
Si % e shpenzimeve shoqërore qendrore jo në para	10,8	13,1%	42,0%	76,1%	198,5 %	115,0 %	100,8 %

Burimi: Të dhënat e Thesarit, Ministria e Financave. Për periudhën 2020 - 2021: Tableta e buxhetit 2020. *Shifrat për periudhën 2020 - 2021 janë vlerësime. Për shpenzimet e pakushtëzuara në buxhetin vendor, për periudhën 2020 - 2021 është marrë si supozim një nivel shpenzimesh i barabartë me vitin 2019.

2.4 Panoramë e Sistemit të Kujdesit për Fëmijët në Shqipëri

Qeveria e Shqipërisë po mbështet ofrimin e kujdesit shoqëror në komunitet në mënyrën më të mirë të mundshme, ndërsa synon të pakësojë kujdesin institucional. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror janë pjesë e Programit të Mbrojtjes Sociale të financuar përmes buxhetit të shtetit. Në Shqipëri, arsimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme ofrohen për moshat nga 0 deri në 5 vjeç. Lloji i parë i institucioneve është çerdhja për fëmijët nga 0 deri në 3 vjeç, dhe lloji i dytë është kopshti për fëmijët nga 3 deri në 5 vjeç.

Kopshtet dhe çerdhet mund të jenë institucione publike dhe jopublike. Shërbimi ofrohet me pagesë si në institucionet publike dhe ato jopublike. Tarifat e çerdheve publike përcaktohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Tarifat e çerdheve jopublike përcaktohen nga pronarët e tyre. Kopshtet publike ofrojnë shërbim të plotë dhe të pjesshëm. Për kopshtet me shërbim të plotë tarifa përcaktohet në nivelin e vetëqeverisjes vendore. Kopshtet me shërbim të pjesshëm gjysmëditor janë pa pagesë. Edhe në rastin e kopshteve jopublike, tarifrat përcaktohen nga pronarët e tyre. Niveli i arsimit i çerdhes dhe kopshtit (pra arsimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme) nuk janë me detyrim në Shqipëri.

Disa nga tiparet janë si më poshtë:

- Në Shqipëri, përgjegjësia për kujdesin shoqëror i përket bashkive. Megjithatë kujdesi ofrohet kryesisht në sistem publik (me përjashtim të programit të kujdesit për fëmijët në zonat rurale), ai ofrohet përmes bashkive vendore dhe jo nga qeveria qendrore.
- Sistemi aktual nuk ndërthuret me aksesin në infrastrukturën e kujdesit formal për fëmijët dhe kujdesit shoqëror që mbështet zhvillimin e fëmijës, nevojat e personave për kujdes dhe aksesin e grave në punësim.
- Për më tepër, për shkak të alternativave të pakta të bazuara në treg, gratë hasin pengesa për t'iu qasur fuqisë punëtore si pasojë e përmbushjes së përgjegjësive të tyre jo vetëm si prindër, por edhe si ofrues kujdesi për të moshuarit.

Shqipëria përballet me një sërë sfidash në kuadër të përparimit drejt një sistemi më të efektshëm të mbrojtjes, mirëqenies dhe kujdesit social. Shërbimet sociale ekzistuese kanë natyrë të copëzuar, primitive dhe të ofrohen sipas rastit. Familjet dhe komunitetet shqiptare po përballen me goditje dhe risqe të tjera që kërcënojnë kohezionin social, për shkak të ndryshimeve në strukturën demografike, migracionit të brendshëm dhe të jashtëm, ndryshimit të rolit të familjes dhe rrjeteve informale.

Kur këto lidhen me gratë dhe ndikimin mbi apo reduktimin e kohës, produktivitetit dhe karrierave, në ekonominë e vendit krijohen pasoja negative. Figura 5 paraqet efektet kryesore për tre grupet.


Tabela 5: Problemet e Kujdesit për Fëmijët dhe Efektet Negative

Prindërit e angazhuar në punë të papaguar kujdesi	Biznesi	Qeveria
Humbje të të ardhurave, produktivitetit dhe përvojës së punës	Humbje të të ardhurave nga humbja e produkteve dhe prodhimitarisë	Humbje të të ardhurave tatimore nga PBB-ja e ulur
Kosto shtesë për sistemimin e fëmijëve	Kosto shtesë për shkëputjes së punonjësve, marrjen dhe rimarrjen në punë.	Humbje nga të ardhurat tatimore të konsumit dhe kosto shtesë për ndihmë ekonomike për të papunët

3. Kosto ekonomike dhe përfitimet e kujdesit për fëmijët

Në nivel ndërkombëtar ka literaturë të bollshme që konfirmon ndikimet e shumta pozitive të shërbimeve cilësore të të nxënit të hershëm dhe kujdesit për fëmijët mbi performancën ekonomike dhe shoqërore. Këto gjetje studimesh kanë identifikuar një sërë përfitimesh për fëmijët, prindërit dhe familjet, për ekonominë vendore dhe kombëtare, dhe për rezultatet afatgjata ekonomike, sociale dhe fiskale.

Qasja ndaj analizës së kostove dhe përfitimeve është përmbledhur në Figurën 2 më poshtë. Në këtë analizë, studimi ka marrë në konsideratë kostot dhe përfitimet e kujdesit universal për fëmijët (arsimi në fëmijëri dhe hershme) për vetë fëmijët, prindërit e tyre (ofruerit e kujdesit) dhe qeverinë. Analiza merr në konsideratë koston e ofrimit të kujdesit për fëmijët dhe një gamë të gjerë përfitimesh afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të cilat mbështeten të gjitha fort në prova.



3.1 Përfitimet e Kujdesit për Fëmijët

Kujdesi për fëmijët mund t'i lejojë prindërit të punësohen kur fëmijët e tyre janë të vegjël, dhe kjo rezultojnë në përfitime publike dhe private. Megjithatë, një justifikim shumë më i rëndësishëm për asistencën publike për kujdesin për fëmijët, janë efektet e drejtpërdrejta të kujdesit të mirë tek vetë fëmijët. Vitet e fëmijërisë së hershme njihen tashmë si vite kritike për zhvillimin e aftësive konjitive dhe shoqërore.

Shqipëria ka nevojë për më shumë kujdes të aksesueshëm, të përballueshëm, përfshirës dhe cilësor për fëmijët, duke kuptuar urgjencën e kësaj sfide për shkak të humbjes së fuqisë punëtore dhe shtimit të cenueshmërisë shumëdimensionale të grave dhe burrave. Ka nevojë të bëhen investime të konsiderueshme, afatgjata dhe të vazhdueshme për ngritjen e sistemit të të nxënit të hershëm dhe kujdesit të fëmijëve në Shqipëri. Të gjithë elementet e shoqërisë, përfshirë biznesin dhe drejtuesit e shoqatave të punës, kanë arritur konsensus të gjerë se ofrimi i të nxënit të hershëm dhe kujdesit për fëmijët ndihmon zgjerimin e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe punësimin, edhe në kuadrin e recesionit të lidhur me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19.

Pavarësisht diskutimeve, sistemi shqiptar i kujdesit për fëmijët thuhet se nuk ekziston ende. Pandemia ka përforcuar konceptin e përbashkët për rëndësinë e shërbimeve të kujdesit për fëmijët në lehtësimin e ekuilibrit ndërmjet pjesëmarrjes së plotë dhe jetës së shëndetshme profesionale të grave.

Kujdesi më i gjerë për fëmijën është me përfitim për prindërit (veçanërisht nënat), për punonjësit, për punëdhënësit dhe për shoqërinë. Me pak fjalë, ka konsensus të fuqishëm ndërsektorial se zgjerimi i të nxënit

të hershëm dhe kujdesit për fëmijën që janë të aksesueshëm dhe me cilësi të lartë, nuk është me përfitim vetëm për shoqërinë, por edhe për Qeverinë e Shqipërisë. Kështu, kjo kthehet në një përparësi të rëndësishme dhe urgjente ekonomike dhe shoqërore.

Përfitimet ekonomike të kujdesit për fëmijën janë afatgjata, dhe ndahen në tre kategori:

- a) Veprimtari ekonomike shtesë e lidhur me zgjerimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit për fëmijët.
- b) Pjesëmarrja më e madhe në fuqinë punëtore, shtimi i punësimit dhe të të ardhurave për prindërit (veçanërisht nënat) e fëmijëve që marrin shërbime të kujdesit për fëmijën.
- c) Përfitime afatgjata ekonomike, shoqërore dhe fiskale që vijnë nga kapacitetet më të mira të jetës së fëmijëve që kanë marrë pjesë në kujdesin për fëmijët gjatë fëmijërisë.

Vlerësimi i marrëdhënies ndërmjet kostove të kujdesit për fëmijën dhe pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore

Një sërë studimesh kanë shqyrtuar ndryshimet e veçanta të politikave me qëllim identifikimin e marrëdhënies shkakore ndërmjet kostos së kujdesit për fëmijën dhe pjesëmarrjes së prindërve në fuqinë punëtore. Megjithatë çmimi i kujdesit për fëmijën mund të ndikojë në pjesëmarrjen e burrave dhe grave në fuqinë punëtore, literatura përqendrohet në ndryshimet në pjesëmarrjen e nënave. Një studim që shqyrton vënien në funksion të kujdesit universal për fëmijën¹⁹ arriti në përfundimin se për çdo 1% rritje të subvencioneve, pjesëmarrja materiale në fuqinë punëtore rritej me 0,24 përqind, ndërsa një studim tjetër²⁰ doli me përfundime të ngjashme, ku për çdo 1 përqind ulje në koston e kujdesit për fëmijët, pjesëmarrja e nënave në fuqinë punëtore rritej me 0,25 përqind.

Zbatimi i një sistemi kombëtar të kujdesit për fëmijën do të krijonte një sërë përfitimesh të rëndësishme për ekonominë e Shqipërisë. INSTAT nuk raporton vlerën e shtuar (ose PBB-në) në industrinë e kujdesit për fëmijën, por mund të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i PBB-së së sektorit duke përdorur profilin kontribut-produkt në sektorin më të gjerë të kujdesit. Nëse supozohet se ka një raport të ngjashëm ndërmjet kostove për paga dhe vlerës së shtuar edhe në kujdesin për fëmijën, do të mund të vlerësohej PBB-ja vjetore në industrinë e kujdesit.

Në terma më të thjeshtë, puna aktuale e papaguar e grave është 60% e PBB-së në Shqipëri, e cila mund të shndërrohet në veprimtari ekonomike. Në fjalë të tjera, thuhet një çerek e grave në Shqipëri janë të përfshira në punë të papaguar dhe ato mund të marrin pjesë në fuqinë punëtore. Këto dy përfitime janë të konsiderueshme si në përmasa, ashtu edhe në shifra.

Ngritja e kujdesit universal për fëmijën do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme punësimin për gratë, si pasojë e kombinimit të hapjes së drejtpërdrejtë, tërthortë dhe të krijuar të vendeve të punës në sektorë ku gjinia e punonjësve është qendrore, si industria e kujdesit, shëndetit, si dhe në sektorin e shërbimeve. Sistemi nuk do të krijojë vetëm punësim të drejtpërdrejtë për personel të kujdesit për fëmijë dhe personel shtesë, por edhe industritë që furnizojnë kujdesin për fëmijën do të rekrutojnë më shumë personel si pasojë e rritjes së kërkesës për produktet e tyre; dhe të gjitha këto vende të reja pune përkthehen në të ardhura më të larta për familjet dhe rikthim të tyre në ekonomi në formën e shpenzimeve familjare, duke pasur kështu efekte të shumëfishta në standardin e jetesës dhe duke krijuar punësim të mëtejshëm.

Të dhënat sugjerojnë se zbatimi i një programi të mirë universal të kujdesit për fëmijën, pra me shkallë universale regjistrimi dhe ofrim shërbimi me cilësi të lartë, me investime vjetore mesatare bruto prej 2,5% të PBB-së, do të jepte kontribut kritik në ekonomikë kombëtare, përfshirë rimëkëmbjen, sipas elementëve të mëposhtëm:

- Në përgjithësi, kujdesi për fëmijën është industri me kërkesë të madhe fuqie punëtore, që e ndihmon të jetë një sektor ku krijohet punësim. Çdo vend pune me kohë të plotë në sektorin e kujdesit për fëmijën krijon ose mirëmban deri në 2.15 ose më shumë vende pune, në varësi të nivelit të punës dhe përdorimit të teknologjisë.
- Rritja në fuqinë punëtore të furnizuar nga gratë në grupmoshat kryesore të prindërimit (nga 20 deri 40 vjeç) është e barabartë me numrin e punëtorëve aktualisht të kufizuar nga puna e papaguar, përmes pjesëmarrjes më të madhe në fuqinë punëtore dhe mundësive më të mëdha për të punuar me kohë të plotë.
- Krijimi i të paktën 5.000 vendeve të drejtpërdrejta të punës në sektorin e kujdesit për fëmijën, me hapjen

19. Studimi i Quebec, Baker, Gruber, dhe Milligan 2005.

20. Lefebvre dhe Merrigan 2005.

e (të paktën) 1.000 vendeve të drejtpërdrejta të punës në vit.

- Krijimi i të paktën 6% shtesë në PBB në industrinë e ndërlidhura (veçanërisht shërbimet), që do të përftojë punë të re nga sektori i zgjeruar i kujdesit për fëmijën. Kjo përfshin edhe vendet e punës shtesë për ndërtimin e godinave.
- Gjatë dhjetëvjeçarit arrihet një rritje eventuale graduale në PBB-në kombëtare vjetore prej rreth 0,05%, si pasojë e ofrimit të zgjeruar të kujdesit për fëmijën dhe rritjes së ofertës nga ana e grave në fuqinë punëtore.
- Punësimi afatgjatë, të ardhurat dhe përfitimet fiskale (të ardhura tatimore shtesë) që vijnë nga kapacitetet e përforcuara konjitive dhe sociale të brezave të ardhshëm që përfitojnë shërbime kujdesi për fëmijën me cilësi të lartë në vitet e formimit të hershëm të jetës së tyre.

3.2 Kostot e Kujdesit për Fëmijën

Duke përdorur qasjen nga poshtë lart, kostot e ofrimit të shërbimeve universale, me kohë të plotë dhe falas të kujdesit për fëmijën, të cilat pasqyrojnë modalitetin tipik të shërbimit, varen nga situata aktuale e punës së papaguar dhe logjika për punën e kujdesit në Shqipëri, përfshirë edhe mbrojtjen. Kostimi do të bazohet në skenarë të ndryshëm që kombinojnë kostot e mbrojtjes sociale, kostot shëndetësore për pagesën e punonjësve të kujdesit për fëmijët, dhe kostot e operimit të kujdesit për fëmijën, etj.

Një model kostosh është një instrument për të vlerësuar në mënyrë të organizuar mënyrat si ndryshimet në një lloj kostoje kanë gjasa të ndikojnë kostot e ofrimit të kujdesit për fëmijën. Në thelb, argumenti ekonomik për financimin e kujdesit publik për fëmijën do të ketë dy drejtime të veçanta. Këto drejtime lidhen me dy grupet që përfitojnë më drejtpërsëdrejti nga kujdesi për fëmijën me cilësi të lartë: prindërit dhe fëmijët.

Në rastin bazë, kosto e vlerësuar mesatare neto e kujdesit për fëmijë për grupmoshat 0 deri 5 vjeç është 260.000 Lekë. Kostot janë të lidhura ngushtë me moshën e fëmijës, si dhe me raportin e stafit dhe regjistrimin, që janë faktorë përcaktues parësorë. Ndërkohë, sigurimi i aksesit për të gjitha familjet (veçanërisht skenari universal) do të ulte kostot neto të kujdesit për fëmijën, sepse do të rriste shkallën e regjistrimit.

Secila nga politikat e reja të financimit të pasqyruara në skenarët do të kishin efekte dramatike për përmirësimin e kujdesit për fëmijën për të gjithë prindërit. Megjithatë, ka një sërë çështjesh shumë të rëndësishme lidhur me fazën fillestare ose tranzicionit që duhet të merren në konsideratë. Nuk ka ambiente të mjaftueshme për të plotësuar të gjithë kërkesën që do të krijohet nëse qeveria vendos të zbatojë menjëherë cilëndo prej këtyre alternativave. Çështjet e tranzicionit ndikojnë qasjen e re të financimit.

Disa nga çështjet e tjera që ndikojnë mbi investimet e kujdesit për fëmijën janë si më poshtë vijon:

- Aksesit në kujdesin për fëmijën varet nga hapësira dhe numri i qendrave. Për këtë arsye, kjo është fusha më madhore e investimeve e kujdesit për fëmijën.
- Numri i grupeve: për shembull a) foshnje 0-18 muaj, b) fëmijë 18-36 muaj, c) parashkollor 3-5 vjeç.
- Personeli jomësimdhënës dhe përfitimet.
- Përveç raportit staf/fëmijë, cilësia e kujdesit për fëmijën varet nga cilësia dhe trajnimi i fuqisë punëtore.
- Kompensimi i fuqisë punëtore; pagesat e pagave dhe përfitimeve përbëjnë aktualisht pjesën më të madhe të kostove të kujdesit për fëmijën, dhe për shumë arsye kompensimi i stafit të kujdesit për fëmijën do të rritet në kuadrin e investimit.
- Nga do të vijnë edukatorët e rinj të fëmijërisë së hershme të nevojshëm në kuadër të zgjerimit të sistemit? Ndërkohë që kujdesi për fëmijën bëhet më i përballueshëm, kërkesa për shërbimin do të rritet, duke rritur edhe kërkesën për staf të trajtuar. Në fjalë të tjera, qeveria mund të duhet të marrë në konsideratë fuqi punëtore shtesë.

Tabela përqendrohet në totalin e përgjithshëm të kostove dhe të ardhurave si pasojë e politikave (skenarëve) të ndryshme të kujdesit për fëmijën. Ajo paraqet edhe kostot shtesë të qeverisë për çdo skenar. Natyrisht, kostot shtesë në rastin bazë janë zero, duke qenë se rasti bazë paraqet situatën aktuale. Në situatën aktuale, të ardhurat e përgjithshme të qeverisë janë 11.600 milion Lekë, ndërsa kostot e qeverisë janë rreth 33.389 milion Lekë. Për qeverinë, të gjitha këto simulime janë shumë pozitive për investimin e bazuar në kriterin e kthimit të investimit. Në fjalë të tjera, sistemi vetëfinancohet me kalimin e kohës, me kusht që qeveria të investojë në ofrimin e kujdesit universal për fëmijën.

4. Kujdesi universal për fëmijën dhe efektet fiskale

Kujdesi për fëmijën është thelbësor për zgjidhjen e sfidave të shumëfishta me të cilat përballen qeveritë, dhe ka shumë pika të ndryshme hyrëse që mund të përdoren për të zgjeruar aksesin në kujdes cilësor dhe të përballueshëm për fëmijën. Ndërkohë që financimet e reja janë padyshim të nevojshme për zgjerimin e aksesit, ka edhe një sërë mundësish për të përdorur financimin në kuadër të fondeve qeveritare që mund të financojnë zgjerimin e kujdesit për fëmijën.

Përpyqjet për zgjerimin e aksesit në kujdes cilësor dhe të përballueshëm për fëmijën do të kërkojnë më shumë qasje të qëllimshme që përfshijnë të gjithë qeverinë në Shqipëri dhe mbështetje për angazhimin në dialog politikash në të gjithë sektorët, hapësirat fiskale dhe buxhetet, dhe organizimet institucionale. Nevojiten instrumente për t'i siguruar politikëbërësve informacionin e nevojshëm për të investuar në sistemet e kujdesit për fëmijët, politikat dhe programet, në veçanti sa i përket kujdesit universal për fëmijët.

Financimi publik i programeve të kujdesit për fëmijën me cilësi të mirë do të ketë efekte të drejtpërdrejta mbi fëmijët në një prej dy mënyrave. Disa fëmijë, për të cilët aktualisht kujdesen vetëm një prind apo një i afërm tjetër i familjes, do të nxiten të kalojnë nga kujdesi i ofruar nga prindi në përdorimin e kujdesit cilësor për fëmijën me kohë të pjesshme ose të plotë.

Provat tregojnë se kujdesin publik për fëmijën është i përballueshëm nga pikëpamja fiskale, sepse shtimi i punësimit të prindërve rezulton në më shumë të ardhura tatimore dhe më pak shpenzime publike për ndihmë ekonomike dhe përfitime të tjera. Ai gjithashtu përmirëson rritjen dhe produktivitetin, duke shumëfishuar kështu efektet mbi të ardhurat. Një sistem kujdesi për fëmijë i financuar me fonde publike nuk mund të ngrihet brenda ditës. Ai kërkon një plan dhe investime afatgjata, me etapa dhe afate të qarta.

Provat nga mbarë bota sugjerojnë se investimet në kujdesin universal për fëmijën mund fusë gratë e përfshira në kujdesin e papaguar ose nënat shtëpiake me nivele të larta arsimit në fuqinë punëtore, që si pasojë do të rriste konsiderueshëm dhe mjaftueshëm PBB-në për të kompensuar koston e programit apo programeve të tjera për përparimin e barazisë gjinore.

Financimi i anës së ofertës (financimi që shkon i drejtpërsëdrejti programeve për mbulimin e të gjitha ose një pjesë të kostove operacionale) thekson se të nxënit e hershëm dhe kujdesin për fëmijën janë një e mirë publike dhe siguron llogaridhënien publike për programet me cilësi të lartë. Financimi i anës së kërkesës (përfitimet tatimore, paratë që i paguhen familjeve) supozojnë se fuqia blerëse garanton zgjedhjen e prindit dhe përforcon idenë se të nxënit e hershëm dhe kujdesi për fëmijën janë të mira të tregut. Një sërë studimesh kanë treguar se qasjet e anës së ofertës sjellin cilësi më uniforme dhe mbulim më të madh²¹. Qasjet e anës së kërkesës priren të jenë përgjithësisht më të shtrenjta, më pak të aksesueshme, me cilësi më të ulët dhe më pak të barabarta.

Për përafrimin e përfitimeve të efekteve zhvillimore/arsimore që vijnë nga të nxënit cilësor në fëmijërinë e hershme me fëmijët dhe shoqërinë, ekzistojnë qasje të ndryshme. Për shkak të studimeve të kufizuara në këtë fushë, të gjitha qasjet mund të japin vetëm një orientim të përgjithshëm të shkallës së përfitimeve nga shpenzimet publike.

21. J. Bennett (2008). Shërbimet e Fëmijërisë së Hershme në Vendet e OECD-së: Shqyrtim i Literaturës dhe Politikave Aktuale në Fushën e Fëmijërisë së Hershme. Zyra e Kërkimit e UNICEF: Innocenti.

Efektet fiskale varen nga një sërë faktorësh, si:

- Kujdesi cilësor për fëmijën është më i shtrenjtë se kujdesi i dobët për fëmijën, kryesisht për shkak të nivelit të pagave dhe përfitimeve që duhet të jenë më të larta me qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e stafit të mirëarsimuar, të qëndrueshëm dhe të përkushtuar.
- Nivelet e aftësive që kërkohen nga ofruesit e kujdesit për fëmijën do të jenë më të larta se ato që kërkohen aktualisht në institucionet e kujdesit për fëmijën.
- Kosto e përgjithshme e shërbimit të kujdesit për fëmijën që propozohet varet nga numri i fëmijëve që do të përdorin kujdesin me kohë të plotë, kujdesin me kohë të pjesshme, apo çerdhen.
- Numri i orëve që fëmija kalon në kujdes varet zakonisht nga statusi i punësimit i nënës: nënat që punojnë me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme.
- Modaliteti i financimit qeveritar.

Ofrimi i kujdesit për fëmijët, qoftë ky i ofruar drejtpërdrejt apo thjesht i bashkërenduar nga qeveria, është qartësisht një fushë me "efekte të jashtme financiare" të shumta, të cilat lidhen me një ndërhyrje të tillë. Zakonisht qeveritë parapëlqejnë politika që nxisin produktivitetin dhe rritjen ekonomike, por kjo ka marrë tashmë rëndësi të re, duke qenë se qeveria po përballlet me deficite të mëdha të mbledhura si pasojë e pandemisë. Ofrimi i aksesit në kujdes për fëmijën me kosto të ulët për familjet nga ana e qeverisë mund të përforcojë rritjen ekonomike përmes shtimit madhor në pjesëmarrjen në fuqinë punëtore.

Në Shqipëri, pjesë të mëdha të shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe kujdesit shoqëror janë transferuar nga qeveria qendrore drejt bashkive, me mbështetjen e institucioneve të qeverisë qendrore. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për planifikimin dhe buxhetimin e përfitimeve të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shumë njësi të qeverisjes vendore përballen me sfidën e madhe të sigurimit të nivelit të përshtatshëm të burimeve të nevojshme nga të ardhurat vendore dhe nga buxheti i shtetit.

Shqipëria shpenzon vetëm 9,3% të PBB-së për mbrojtje sociale (pa përfshirë shëndetësinë), çka është më pak se gjysma e mesatares së BE-së (19,1% pa përfshirë shëndetësinë dhe 27,8% përfshirë shëndetësinë).

- Ndër përfitimet ekzistuese, pensionet pleqërisë mbulojnë numrin më të madh të përfituesve dhe kanë ndikimin më të rëndësishëm në uljen e varfërisë. Pavarësisht reformës së pensioneve të kohëve të fundit për përforcimin e qëndrueshmërisë financiare, Fondi i Sigurimeve Shoqërore është në deficit prej rreth 2% të PBB-së.
- Përveç pensioneve të pleqërisë, mbulimi i skemës së kontributeve mbetet i ulët. Në veçanti, një numër i madh punonjësish në sektorët informal dhe jostandard të punësimit nuk kualifikohen për përfitime të tjera të skemës së kontributeve në rast papunësie, aftësie të kufizuar dhe lëndimi gjatë punësimit, si dhe për të kërkuar përfitimet e ndihmës ekonomike.
- Si rezultat i reformës së kohëve të fundit të ndihmës sociale me qëllim përmirësimin e përcaktimit të përfitimeve monetare të ndihmës ekonomike, numri i përfituesve të programit të ndihmës ekonomike ra konsiderueshëm nga 15,1% në vitin 2013 në 8,7% në vitin 2019, ndërkohë që shpenzimet për skemën ranë nga 0,34% në vitin 2013 në 0,21% të PBB-së në vitin 2019.

Tabela përmbledh alternativat kryesore dhe efektet e tyre financiare. Qeveria, dhe veçanërisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duhet të eksplorojnë të gjithë skenarët dhe alternativat fiskale, ndikimet sociale shoqëruese përfshirë çështjet gjinore, risqet dhe kompromiset.

Tabela 6: Efektet Fiskale të Skenarëve të Ndryshëm të Ofrimit të Kujdesit Universal për Fëmijën (çmimet e vitit 2019)

	Aktuale		Skenari 1	Skenari 2	Skenari 3
	0-2 vjeç	4-5 vjeç	Nëse rritet regjistrimi i fëmijëve	Nëse regjistrimi i fëmijëve rritet së bashku me përmirësimin e cilësisë	Regjistrim universal me shërbime të kujdesit për fëmijët me cilësi të lartë
Popullatat e fëmijëve	143,546	55355	171,224	171,224	171,224
Shkalla e Regjistrimit	50%	100%	50%	50%	100%
Regjistrim i plotë	71773	55355	171,224	171,224	171,224
Orë në javë/fëmijë	40	40	40	40	40
Raporti fëmijë-personel	4	8	4	4	4
% e stafit mësimor	50%	50%	50%	50%	50%
Numri i stafit mësimor	17943	13839	42806	57075	85612
Niveli i pagës (LEK në muaj)	60000	65000	65000	65000	65000
Kosto vjetore (LEK)	12919140000	10794225000	33388582500	44518110000	66777165000
Kosto e përgjithshme (mil. LEK)	12919	10794	33389	44518	66777
PBB (2019)	1636731	1636731	1636731	1636731	1636731
(si % of PBB-së)	0.789	0.659	2.040	2.720	4.080
Kosto për fëmijë p.a. (LEK)	90,000	195,000	195,000	260,000	390,000

Burimi: INSTAT (<http://www.instat.gov.al>) për PBB, popullatën e fëmijëve, dhe përlogaritjet e autorit

Në kuadër të këtyre alternativave, është e qartë që Shqipëria duhet të përqendrohet në zgjerimin e sigurimeve shoqërore duke trajtuar evazionin fiskal dhe ekonominë informale, me qëllim mbledhjen e më shumë të ardhurave për fuqizimin e mëtejshëm të skemave të kontributeve. Rekomandohet që këto alternativa dhe të tjera të diskutohen në kuadër të një procesi kombëtar dialogu.

Tabela 7: Vlerësimi i Investimeve Publike për Shërbimet e Kujdesit për Fëmijën për Tre Skenarët

	Skenari 1	Skenari 2	Skenari 3
	Nëse rritet regjistrimi i fëmijëve	Nëse rritet regjistrimi i fëmijëve rritet së bashku me përmirësimin e cilësisë	Regjistrimi universal me shërbime të kujdesit për fëmijët me cilësi të lartë
Mbulimi i fëmijëve 6 muaj- 2 vjeç	100%	1000%	100%
Mbulimi i fëmijëve 3 - 5 vjeç	100%	100%	100%
Orët në javë/fëmijë	40	40	40
Raporti fëmijë-personel	Aktualisht (12:1)	Legjislativi (4:1 for 0-2; 8:1 for 3-5)	Legjislativi (4:1 for 0-2; 8:1 for 3-5)
Niveli i pagës (LEK në muaj)	Aktualisht 50000	Mësuesi	Mësuesi
Nivelet e kualifikimit	8,101	14,139	19,579
Kosto e përgjithshme vjetore bruto (mil. LEK)	1.30%	2.30%	3.20%
(si % e PBB-së)	82,943	144,760	200,449
Kosto për fëmijë p.a (LEK)	19.70%	34.40%	37.00%

Burimi: Përlogaritjet e autorit

Nevojat neto për financim

Duke qenë se të gjitha vendet e hapura të punës supozohet se do të plotësohen në një mënyrë apo në një tjetër, rezultatet e efekteve të kërkesës për punësim mund të përdoren për të përlogaritur të ardhurat tatimore dhe të ardhurat shtesë. Kjo mund t'i shtohet shpenzimeve të reduktuara për Kujdesin Universal të përlogaritura në pjesën e mëparshme.

Tabela 8: Arsyetimi i Përlogaritur i Investimit për Kujdesin Universal për Fëmijën

Skenari	Skenari 1	Skenari 2	Skenari 3
			(milion LEK)
Kosto vjetore bruto	33,389	44,518	66,777
(si % e PBB-së)	2.04%	2.72%	4.08%
Të ardhura të drejtpërdrejta tatimore (25%)	8,347	11,130	16,694
Të ardhura të tërthorta tatimore (10%)	3339	4452	6678
Hendeku i financimit	21,703	28,937	43,405
PBB e vitit 2019	1,636,731	1,636,731	1,636,731
(so % e PBB-së)	1.33%	1.77%	2.65%
% vetëfinancimit	40%	50%	50%
Vitet pa fitim	7	12	14
Rritja në % së PBB-së	3.37%	4.49%	6.73%

Sa i përket vendeve të punës në kujdesin për fëmijën, vlerësimi i të ardhurave shtesë nga tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore shtesë të punëdhënësve dhe punonjësve, është i thjeshtë, duke qenë se supozohet që këto vende pune të kenë paga fikse të përcaktuara për çdo skenar.

Shuma totale e të ardhurave tatimore dhe shpenzimeve të ulura për sigurime shoqërore mund të përlogaritet nga burime të ndryshme, përfshirë edhe shumën që aktualisht shpenzohet për subvencionimin e kujdesit për fëmijën. Këto shuma mund t'i zbriten investimeve vjetore bruto për të arritur tek një ide e 'qëndrueshmërisë fiskale afatshkurtër', ose në fjalë të tjera financimit në nevojshëm për investimin nga tatime apo hua shtesë.

Sidoqoftë, kërkesat për financim neto mbeten të konsiderueshme. Financimi i pjesës së mbetur është pjesë e një diskutimi politik. Për shembull, uljet e tatimeve ose rritja e pragjeve tatimore mbi inflacion dhe shkurtimi apo ngrirja e tatimeve mbi alkoolin dhe karburantin janë masa me efekte të dyshimta mbi të ardhurat dhe veprimtarinë ekonomike, kur merret në konsideratë amullia në produktivitet që shoqëroi rritjen në punësim.

Efektet fiskale gjatësore nga punësimi

Kërkime të shumta mbi kthimin e investimit në arsimin e hershëm tregojnë se investimi publik në programe me cilësi të mirë të kujdesit për fëmijën me synime të qarta, ka vlera aktuale pozitive neto ku përfitimet tejkalojnë kostot për shkak të uljes së shpenzimeve për ndihmë ekonomike, krim dhe shëndetësi, si dhe për shkak të rritjes së punësimit dhe shtimit të të ardhurave gjatë jetës për vetë fëmijët në periudhë afatgjatë si dhe për prindërit në periudhën më afatshkurtër.

Kthimet vjetore të investimit për programet e të nxënimit të hershëm dhe kujdesit që synojnë fëmijët e grupeve të disavantazuara janë përtej objektit të këtij dokumenti. Megjithatë një model i plotë gjatësor është përtej objektit të kësaj analize, është e mundur të simulohen disa nga përbërësit e këtyre efekteve, veçanërisht ndryshimi në të ardhurat gjatë gjithë jetës së nënave, si pasojë e ofrimit të shërbimit universal. Mund të përdoret një metodë e vlerës aktuale neto për një nënë tipike me të ardhura mesatare. Përfitimet që duhet

të zbriten janë të ardhurat fiskale vjetore shtesë që vijnë nga pakësimi i të ardhurave që lidhen me fëmijën për shumicën e nënave që aktualisht janë në sistem. Kostot që duhet të zbriten janë kostot e përgjithshme të kujdesit për fëmijën për vitet e mbulimit me shërbim. Nëse e para është të paktën e barabartë me këtë të fundit, atëherë programi konsiderohet i vetëfinancuar.

Megjithëse politika aktuale dhe planet e ardhshme për kujdesin për fëmijën mbeten më së shumti të papërshtatshme për trajtimin e sfidave me cilësinë, aksesueshmërinë dhe përballueshmërinë e kujdesit për fëmijën në Shqipëri, argumentet lidhur me mungesën e fondeve kanë qenë shpesh arsyeja kryesore për kundërshtimin e shtimit të investimeve në sektor. Ky vlerësim ekzaminoi këto pretendime dhe në këtë kuadër ka hartuar një rast fiskal pozitiv. Siç tregojnë rezultatet e kostimit, investimi në kujdesin universal falas për fëmijën kërkon shuma të konsiderueshme shpenzimesh vjetore, që arrijnë vlera rreth dyfish të shpenzimeve publike për kujdesin për fëmijën të vëna në dispozicion nga qeveria për të ardhmen e afërt. Ky vlerësim tregon se financimi i një programi ambicioz investimesh në kujdesin për fëmijën dhe vijueshmëria e tij vit pas viti është diçka e përballueshme edhe në kuadër të strukturës ekzistuese fiskale në Shqipëri. Duke marrë në konsideratë të ardhurat tatimore dhe uljen e shpenzimeve të sigurimeve shoqërore që vijnë nga vendet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të punës të hapura në ekonomi, vetëm rreth 3 përqind (e çdo valute) të shpenzuar do të kërkonte financim shtesë në baza të përvitshme.

Sidoqoftë, rezultatet gjithashtu tregojnë se përfitimet afatgjata fiskale kanë gjasa të sigurojnë rikuperimin e plotë të investimit në kujdesin për fëmijën, bazuar në simulimet me familjet tipike (nënat me dy fëmijë dhe të ardhura mesatare). Sa i përket etapave të ndryshme të potencialit të të ardhurave, analiza edhe njëherë tregon se në kuadër të strukturës fiskale ekzistuese, investimi mund të barazojë të ardhurat në 8 deri 13 vjet, që është brenda periudhës normale të punësimit pas lindjes.

Një ngushtim i tillë i hendeut të të ardhurave ndërmjet gjinive është gjithashtu një objektiv tjetër politikash në vetvete, që do të përmirësonte pavarësinë ekonomike të grave. Punësimi i nënave mund të përmirësohet konsiderueshëm nëse ofrohen shtysat e duhura dhe nëse ka një sistem të vërtetë kujdesi për fëmijën që është i përballueshëm, i aksesueshëm dhe me cilësi të lartë. Për më tepër, punësimi i krijuar në sektorin e kujdesit për fëmijën dhe më gjerë në ekonomi mund të sjellë përfitime joproporcionale për gratë. Përlllogaritjet tona tregojnë se kjo do të ngushtonte hendeqet e përgjithshme gjinore të punësimit me rreth gjysmën e vlerës së tyre.

Megjithatë, përfitimi kryesor i kujdesit për fëmijën mbetet investimi në mirëqenien dhe zhvillimin shoqëror dhe konjitiv të fëmijëve. Ka edhe një argument ekonomik në këtë kuadër që thotë se në të ardhmen produktiviteti do të rritet përmes arsimit më të mirë, aftësive më të mira shoqërore dhe aftësisë më të mirë për t'u përshtatur me tregjet e punës me dinamizëm të madh dhe të bazuar në teknologji. Gjithashtu do të ulëshin pabarazitë në shanset e jetës dhe mundësitë për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe kohezionin shoqëror për të gjithë. Të dy këto argumente justifikojnë shpenzimet publike, sepse ato kanë një element të së mirë publike që është aspekti i infrastrukturës sociale të kujdesit për fëmijën. Përcaktimi sasior i përfitimeve afatgjata për fëmijët dhe shoqërinë është më i ndërlikuar, por jo i pamundur. Megjithatë, ky përcaktim shkon përtej objektit të këtij studimi. Mund të ketë nevojë për modelim me qëllim ekzaminimin e ndryshimeve në sistemin e testuar që përshtatet (i përgjigjet goditjeve) të mbrojtjes sociale, për përmirësimin e incentivave të punës edhe në një sistem të ri të kujdesit falas për fëmijën.

5. Përfundime

Ulja e varfërisë në Shqipëri dhe veçanërisht ulja e numrit të fëmijëve të varfër, po arrihet përmes krijimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve që synojnë shtimin e mundësive për sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në përgjithësi, dhe të grave të varfra në veçanti. Përvoja e varfërisë është e ndryshme për burrat dhe gratë në Shqipëri. Kuptimi i dimensioneve të veçanta gjinore dhe implikimeve për brezat e ardhshëm kërkon me domosdoshmëri hartimin e politikave dhe prioriteteve të reja, si dhe zbatimin e programeve të krijuara për uljen e varfërisë përmes respektimit të të drejtave të grave dhe uljes së pabarazisë gjinore.

Përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve, dhe veçanërisht fëmijëve të varfër, lidhet ngushtë me fuqizimin e rolit të grave dhe vajzave që përbëjnë gjysmën e popullsisë së Shqipërisë. Nxitja e shpërndarjes së barabartë të fuqisë punëtore në shoqërinë shqiptare nga pikëpamja individuale, ekonomike dhe politike, do të ketë një ndikim në kontrollin më të madh të grave mbi jetën e tyre individuale dhe shoqërore, dhe do t'i lejojë atyre të marrin pjesë dhe të kenë ndikimin e tyre në strukturat vendimmarrëse. Fuqizimi i rolit të grave dhe vajzave duhet të shihet si një vizion për zhvillim që mund dhe që duhet të përmbushet.

Të nxënit e hershëm dhe kujdesin për fëmijën kanë efekte pozitive për prindërit. Të nxënit e hershëm dhe kujdesi për fëmijën duhet të shërbejnë si mjet për transformimin e besimeve, sjelljeve dhe zakoneve që mëkojnë diskriminimin me bazë gjinore dhe pabarazinë gjinore.

Në këtë kuadër, pengesa që nuk i lejon gratë shqiptare të kenë akses në tregun e punës është mungesa e kujdesit të mjaftueshëm për fëmijën (strukturat parashkollore) dhe shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Pakësimi i kujdesit parashkollor dhe mungesa e strukturave të shërbimeve shoqërore të projektuara për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara ka rezultuar në rritjen e numrit të grave në moshë pune të përfshira në punë kujdesi të papaguar dhe që mbeten jashtë tregut të punës për shkak të përgjegjësisë të tyre familjare lidhur me fëmijët, apo të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Hartimi i politikave dhe programeve që krijojnë kujdes universal për fëmijën, ose mbrojtje sociale për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, do të lejonte pjesëmarrjen e grave në veprimtaritë e punësimit dhe do të ulte varfërinë duke përforcuar nivelin ekonomik të familjes.

5.1 Hartimi i Argumentit Fiskal për Kujdesin Universal për Fëmijën në Shqipëri

Kujdesi për fëmijën është thelbësor për zgjidhjen e sfidave të shumëfishta me të cilat përballen qeveritë, dhe ka shumë pika të ndryshme hyrëse që mund të përdoren për të zgjeruar aksesin në kujdes cilësor dhe të përballueshëm për fëmijën. Ndërkohë që financimet e reja janë padyshim të nevojshme për zgjerimin e aksesit në kuadër të përmasave të nevojshme, ka edhe një sërë mundësish për të përdorur financimin në kuadër të programeve ekzistuese që mund të financojnë zgjerimin e kujdesit për fëmijën.

Disa nga këto fusha që kërkojnë vëmendje janë:

- Shtimi i investimeve publike në kujdesin për fëmijën për të siguruar që gratë dhe prindërit e të gjitha gjinive të mund të kthehen në punë dhe të japin kontribut në PBB.
- Fondet e drejtpërdrejta të përshtatshme për trajtimin e kostove të shtuara dhe mbështetjen e kujdesit për fëmijën
- Përmbushja e rolit kritik afatgjatë shoqëror dhe ekonomik të kujdesit për fëmijën, përmes:
- Investimeve të konsiderueshme në infrastrukturën fizike: qendrat e reja kontributi në zinxhirin e furnizimit
- Investimeve të konsiderueshme në kapitalin njerëzor: edukatorët e fëmijërisë së hershme dhe profesionet e tjera përkatëse
- Mekanizmat më të gjerë të koordinimit të politikave.

Hulumtimi dhe shfrytëzimi i këtyre mundësive në Shqipëri mund të sigurojë maksimumin e kthimit të investimeve dhe mund të ndihmojë qeveritë të arrijnë objektiva të shumëfishtë me burime të kufizuara financiare. Në periudhën afatshkurtër, këto mundësi ofrojnë alternativa praktike dhe të shpejta për shtimin e burimeve të disponueshme për të mbështetur zgjerimin e kujdesit për fëmijën, ndërkohë që qeveritë punojnë për vënien në dispozicion të burimeve të reja.

Bazuar në shpenzimet publike për shërbimet shoqërore dhe duke marrë me kujdes në konsideratë informacionin në fjalë, ky studim vëren se:

- a) Ka nevojë për të dhëna dhe analiza të treguesve në përputhje me standardet ndërkombëtare me qëllim hartimin e politikave dhe programeve të efektshme universale sociale dhe/ose të kujdesit për fëmijën dhe mbrojtjes sociale.
- b) Caktimi i burimeve nuk është ende i efektshëm dhe i decentralizuar. Ka nevojë për hapësirë të përshtatshme fiskale dhe buxhetim të burimeve financiare për politikën shoqërore me në qendër gjininë dhe fëmijën, veçanërisht në nivel qendror dhe vendor;
- c) Kapacitetet institucionale përgjegjëse për politikën sociale me bazë gjinore dhe për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror (kujdesit për fëmijën), duhet të forcohen si në nivel kombëtar, ashtu edhe vendor.

Si përmbledhje, studimi mbështet disa pika hyrje për konsideratë në kuadër të prioritetëve të mëposhtme:

- d) Forcimin e legjislacionit, sistemit, reformës së politikave dhe legjislacionit, si dhe zbatimin e përpjekjeve për investimin në kujdesin universal për fëmijën (hapësirën fiskale për buxhetim).
- e) Garantimin e koordinimit ndërmjet sektorëve qeveritarë në nivel qendror, rajonale dhe vendor për zbatimin e politikave që synojnë realizimin e barazisë gjinore, veçanërisht në kujdesin e papaguar.
- f) Nxitjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, përmes hartimit dhe zbatimit të politikave të kujdesit shoqëror me bazë gjinore.
- g) Krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të kategorizuar të mbledhjes së të dhënave bazuar në tregues të cilët masin me saktësi punën e papaguar të grave dhe fëmijët e prekur.

Trajtimi i Kujdesit Universal për Fëmijën

Studimi jep prova konkrete se si investimet publike me ndjeshmëri gjinore kanë efekte të rëndësishme lidhur me faktin se kush përfiton nga kujdesi për fëmijën dhe hapja e vendeve të punës. Përtej "kush" përfiton, raporti paraqet edhe një analizë krahasimore të "sa dhe çfarë lloji përfitimi" mund të pritët nga çdo dollar shtesë shpenzimesh publike me ndjeshmëri gjinore, krahasuar me shpenzimin në kujdesin universal për fëmijën që nuk merr parasysh gjininë. Gjetjet e studimit tregojnë se mbështetja e zgjerimit të kujdesit universal për fëmijët do të sillte shumë më tepër përfitimet në zhvillimin e fëmijërisë së hershme, përfshirë vende pune gjithsej dhe në veçanti shumë më tepër vende pune për gratë në shumë sektorë miqësorë me gjininë, megjithatë duke hapur një numër të konsiderueshëm vendesh pune për burrat. Këto vende pune janë gjithashtu edhe të një cilësie më të lartë: një numër i konsiderueshëm i tyre është për punëtorët me nivel të ulët aftësisë nga familje me të ardhurat më të ulëta (për shembull 30%), dhe për punëtorët e papunë. Së fundmi, efekti i kombinuar mbi kërkesën dhe ofertën për fuqi punëtore, si dhe ndikimin e zgjerimit të kujdesit universal për fëmijën mbi uljen e varfërisë do të ishte i konsiderueshëm, duke krijuar në të njëjtën kohë kërkesë për punësim në favor të grave, duke rritur ofertën e grave për punësim dhe duke shtuar familjet me dy burime të ardhurash. Kështu, investimet publike me ndjeshmëri gjinore (politikën fiskale) nuk janë pozitive vetëm për gratë, por edhe për burrat, të papunët, personat me nivel të ulët aftësisë dhe të varfrit.

Investimet publike në kujdesin universal për fëmijën lidhen me disa fusha themelore si:

- a) Rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve në ministrinë përkatëse lidhur me angazhimet e qeverisë për rëndësinë e kujdesit që krijon një mundësi për të garantuar që shërbimet e kujdesit të financohen në mënyrë të përshtatshme ose që investimet me ndjeshmëri gjinore (kujdesi i papaguar) të rriten.
- a) Rritjen e transparencës së shpërndarjes dhe proceseve të buxhetit në kujdesin për fëmijët.
- a) Rishpërndarjen e përgjegjësisë të kujdesit midis grave dhe burrave që duhet të jetë objektiv qendror i politikave të kujdesit.
- a) Rritjen e caktimeve të burimeve për kujdesin për fëmijën (shëndetësi, arsim dhe mirëqenie sociale)
- a) Rijetëzimin social dhe jo vetëm fizik, infrastrukturë përmes investimeve në sektorin e kujdesit.
- a) Forcimin e politikave të kujdesit për fëmijën në investimet që i japin përparësi kujdesit për fëmijën, përmes modeleve të përshtatshme.
- a) Investimit në shërbime kujdesi cilësore, politika kujdesi, dhe infrastrukturën përkatëse për kujdesin me qëllim pakësimin e pengesave shoqërore dhe ekonomike dhe përparimin e përfshirjes, barazisë gjinore dhe trajtimit të barabartë gjinor.
- a) Ngritjen e një ekonomie kujdesi me në qendër trajtimin e barabartë, barazinë dhe prosperitetin e përbashkët,

duke punuar me punonjësit e kujdesit përfshirë punonjësit e papaguar të kujdesit; përfituesit e kujdesit dhe ekonomistët feministë.

- a) Rritjen e kapaciteteve të shërbimeve dhe institucioneve të kujdesit për përballimin e kostove të drejtpërdrejta të operimit.
- a) Përcaktimin, monitorimin dhe zbatimin e standardeve kombëtare për shërbimet cilësore të kujdesit për fëmijën, bazuar në praktikatat më të mira të mbështetura në prova, të cilat mbulojnë nivelet e plotësimit me staf, trajnimin, menaxhimin dhe ofrimin të shërbimit, si dhe mbrojtjen e të drejtave të punës.
- a) Vënien në zbatim të politikave dhe programeve, përfshirë masave fiskale (p.sh. tatime) miqësore për kujdesin dhe me përgjigjshmëri gjinore, që synojnë gratë që jetojnë me të ardhura të ulëta dhe familjet e tyre, me qëllim ndihmën lidhur me kostot e dhënies së kujdesit.

Rekomandime Kyçe

Është momenti i duhur për rishqyrtimin e prioriteteve ekonomik dhe që Qeveria e Shqipërisë të investojë në ngritjen e ekonomisë njerëzore femine që funksionon për të gjithë qytetarët, përfshirë gratë më të varfra dhe grupet e marginalizuara. Studimi propozon gjatë veprimet e mëposhtme për eliminimin e hendekut ndërmjet të pasurve dhe të varfërve dhe për të ndihmuar në realizimin e të drejtave të punëtorëve/ofruesve të kujdesit të papaguar, duke pranuar rëndësinë e kujdesit për mirëqenien e shoqërisë dhe ekonomisë në Shqipëri.

1. Investimi në sistemet kombëtare të kujdesit për fëmijën (përfshirë lloje të tjera kujdesi) me qëllim trajtimin e përgjegjësive joproporcionale për punën e kujdesit që ndërmerren nga gratë dhe vajzat
Qeveria duhet të investojë në sisteme kombëtare universale të kujdesit për fëmijën. Sistemet kombëtare të kujdesit për fëmijën duhet të bëjnë investime për ofrimin e kujdesit universal për fëmijën, kujdesit universal për të moshuarit dhe kujdesit për personat me aftësi të kufizuara. Këto duhet të përfshijnë edhe akses në kujdes shëndetësor dhe arsim cilësor, si dhe në ofrimin e mbrojtjes sociale universale, si pensione dhe përfitime për fëmijët.
2. Fundi i pasurisë ekstreme për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme
Me qëllim rritjen e investimeve në kujdesin për fëmijët, qeveria duhet të ndërmarrë hapa të rëndësishëm vendimtarë duke taksuar pasurinë, të ardhurat e larta dhe duke trajtuar boshllëqet dhe rregullat e papërshtatshme tatimore që i lejojnë korporatave dhe individëve të pasur të mënjanojnë përgjegjësitë e tyre tatimore.
3. Hartimi i legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë personave që bëjnë punë të papaguar kujdesi dhe sigurimin e pagave dinjitoze për punonjësit e paguar të kujdesit
Në kuadër të sistemeve kombëtare të kujdesit për fëmijët, qeveria duhet të sigurojë politika ligjore, ekonomike dhe të tregut të punës që mbrojnë të drejtat e të gjithë ofruesve të papaguar dhe punonjësve të paguar të shërbimit, dhe të monitorojë zbatimin e tyre me qëllim që të gjithë punëtorët e papaguar të kenë akses në ndihmë ekonomike apo një pagë dinjitoze, si dhe të punojë për eliminimin e hendeqeve gjinore të pagës.
4. Të garantohet që ofruesit e kujdesit kanë ndikim mbi proceset vendimmarrëse
Qeveritë duhet të lehtësojnë pjesëmarrjen e ofruesve të papaguar të kujdesit dhe punonjësve të kujdesit në forumet dhe proceset politikëbërëse në të gjitha nivelet dhe të investojnë burime për mbledhjen e të dhënave gjithëpërfshirëse që mund të japin informacion më të mirë për politikëbërjen, si dhe të vlerësojnë ndikimin e politikave mbi ofruesit e kujdesit.
5. Kujdesi duhet të marrë vlerën e duhur në politikatat dhe praktikatat e biznesit
Bizneset duhet të kuptojnë vlerën e punës së kujdesit dhe të ruajnë mirëqenien e punonjësve. Shoqëritë dhe bizneset duhet të marrin përgjegjësitë e tyre dhe të japin kontribut për përmbushjen e OZHQ-ve duke paguar pjesën e tyre të drejtë të tatimeve, duke zbatuar praktika punësimi miqësore me familjen si orar fleksibël pune dhe leje të paguar, dhe duke përdorur reklama progresive dhe komunikim publik për të sfiduar shpërndarjen e punës së kujdesit në bazë të gjinisë

Hapat e mëtejshëm

Agjenda e punës kërkimore në të ardhmen do të përfshinte zhvillimin e një modeli ekonomik që përfshin efektet e shumëfishta të infrastrukturës së kujdesit universal për fëmijën: hapjen e vendeve të punës, uljen e varfërisë, pjesëmarrjen në fuqinë punëtore, barazinë gjinore, ndryshimin e modeleve të konsumit, kapitalin e përmirësuar njerëzor dhe produktivitetin në punë, si dhe mundësitë e barabarta për fëmijët në periudhën afatgjatë.

Referencat

- Antonopoulos, R., K. Kim, T. Masterson dhe A. Zacharias (2011) 'Investimi në Kujdes: Një Strategji për Hapjen e Efektshme dhe të Barabartë të Vendeve të Punës'. Levy Economics Institute Working Paper No. 610. Nju Jork: Bard College.
- Një Shqyrtim i Shpenzimeve të Buxheteve Vendore për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, Shqipëri 2018.
- Centre for Spatial Economics. (2009). Vlerësime të Mungesave në Fuqinë Punëtore: Të Kuptojmë Mungesat e Fuqisë Punëtore në Arsimin e Fëmijërisë së Hershme dhe Projektet e Kujdesit. http://www.ccscc-cssge.ca/sites/default/files/uploads/Projects-Pubs-Docs/2.4-WFSEstimatesMain_Eng.pdf.
- De Henau, J. (2017a) 'Punësimi Afatshkurtër dhe Efektet Fiskale të Investimit në Kujdesin Universal për Fëmijët: Një Analizë Simulimi Makro-Mikro për MB-në'. Artikull i paraqitur në seminarin për Makroekonominë Gjinore në Levy Economics Institute of Bard College, Nju Jork, 13-15 shtator.
- HAVNES, T. dhe MOGSTAD, M. (2011), 'Asnjë Fëmijë i Lënë Pas: Kujdesi Universal për Fëmijët dhe Rezultatet Afatgjata të Fëmijëve', American Economic Journal: Economic Policy 3(2), fq. 97-129 (shih artikullin e diskutimit IZA 4561, i disponueshëm në <http://ftp.iza.org/dp4561.pdf>)
- Ilkharan, I. 2018. "Promovimi i Fuqizimit Ekonomik të Grave: Njohja dhe Investimi në Ekonominë e Kujdesit." Issue Paper. UN Women, Nju Jork.
- ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës). 2018a. Puna e Kujdesit dhe Vendet e Punës në Kujdes për të Ardhmen e Punësimit Gjenevë: ILO.
- INSTAT, 2015. Anketimi i Grupit të Treguesve të Shumëfishtë, raporti paraprak (projekt dokument), Tiranë
- 2019d. "Investimi në Kujdesin Universal për Fëmijën në Afrikën e Jugut, Turqi dhe Uruguai: Një Analizë Krahasimore e Kostove, Efekteve Afatshkurtra të Punësimit dhe të Ardhurave Fiskale." Nju Jork: UN Women.
- M. Moysen dhe A. Burlock. (2018). Përdorimi i Kohës: Barra e Përgjithshme e Punës, Puna e Papaguar dhe Argëtimi. Statistics Canada. <https://www150.statcan.gc.ca/n1/pub/89-503-x/2015001/article/54931-eng.htm>. Kur përfshihen veprimtaritë e punës së papaguar dhe të punës së paguar, pjesa e grave është 65 përqind e të gjitha orëve të punës së papaguar dhe ato përbëjnë 53,5 përqind të orëve të përgjithshme ditore të punës së papaguar dhe të paguar të grave.
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Organizata Ndërkombëtare e Punës, Fondi Monetar Ndërkombëtar.
- Salvador, S. 2019. "Sistemi i Integruar Kombëtar i Kujdesit në Uruguai: Një Mundësi për Fuqizimin Ekonomik të Grave." UN Women, Montevideo.
- Staab, S. 2015. "Barazia Gjinore, Zhvillimi i Fëmijës dhe Hapja e Vendeve të Punës: Si të Përftohet 'Dividendi i Trefishtë' nga Arsimit në Fëmijërinë e Hershme dhe Shërbimet e Kujdesit." Dokumenti i Politikave Nr. 2 UN Women, Nju Jork.
- UNICEF (2008). Tranzicioni i kujdesit për fëmijën: Një tablo e arsimit në fëmijërinë e hershme dhe kujdesit në vendet ekonomikisht të përparuara. Innocenti Report Card 8. Firenze, Itali: Qendra e Kërkimeve Innocenti e UNICEF. <https://www.unicef-irc.org/publications/507-the-child-care-transition-a-league-table-of-early-childhood-education-and-care-in.html>.
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët. (2019). Një Botë e Gatshme për të Mësuar: Dhënia Përparësi Arsimit në Fëmijërinë e Hershme Nju Jork: UNICEF. <https://data.unicef.org/resources/a-world-ready-to-learn-report/>.
- UNDP Turqi (2020). Hendeqet Gjinore në Ekonominë e Kujdesit gjatë Pandemisë së Covid-19 në Turqi: Punim Kërkimor. Ankara: UNDP Zyra e Vendit Turqi.

Tabelat

Tabela 1: Vlera e Punës së Papaguar si Përqindje e PBB-së për Gratë dhe Burrat, USD/për frymë, 2011

Tabela 2: Kohëzgjatja Ditore e Kaluar në Punë të Papaguar dhe në Punë të Paguar (Orë brena një Periudhe 24 orëshe)

Tabela 3: Leja e Lindjes për Baballarët dhe Leja Prindërore në Shqipëri

Tabela 4: Shpenzimet për Mbrojtjes Sociale në Shqipëri 2015-2021

Tabela 5: Problemet e Kujdesit për Fëmijët dhe Efektet Negative

Tabela 6: Efektet Fiskale të Skenarëve të Ndryshëm të Ofritit të Kujdesit Universal për Fëmijën (çmimet e vitit 2019)

Tabela 7: Vlerësimi i Investimeve Publike për Shërbimet e Kujdesit për Fëmijën për Tre Skenarët

Tabela 8: Arsyetimi i Përlllogaritit i Investimit për Kujdesin Universal për Fëmijën

